# PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE TË "ARSIMIT PARASHKOLLOR"

Program orientues

Koordinator:
Aurela Zisi

2025-2026

## A. TABELA E PËRMBAJTJES

**TABELA E PËRMBAJTJES** 1

**HYRJE** 3

**SYNIMET DHE QËLLIMET E PROGRAMIT** 5

**PËRMBAJTJA E PROGRAMIT** 7

**Orientime dhe udhëzime për testimin e informatizuar – Kategoria "Mësues i kualifikuar"** 8

Fushat e testimit të mësuesve – Kategoria "Mësues i kualifikuar" 9

Modele pyetjesh me alternativa 17

**Orientime dhe udhëzime për planifikimin dhe zhvillimin e aktivitetit të hapur ditor - Kategoria "Mësues i kualifikuar" dhe "Mësues specialist"** 27

Orientime rreth planifikimit të aktivitetit të hapur ditor 29

Udhëzime për plotësimin e Formatit të instrumentit për vlerësimin e aktivitetit ditor për "Mësuesin e kualifikuar" (Shtojca nr.1) dhe për "Mësuesin specialist" (Shtojca nr.2) 31

**Kriteret e vlerësimit të aktivitetit të hapur ditor** 35

**Orientime dhe udhëzime për projektin kurrikular–Kategoritë "Mësues specialist" dhe "Mësues mjeshtër"** 50

Struktura dhe përmbajtja e rubrikave të projektit kurrikular 52

*b) Disa aspekte që duhet të mbajnë parasysh fëmijët:* 56

**Regjistrimi i aktiviteteve** 56

**Vlerësimi dhe reflektimi** 57

**Komentet e fëmijëve** 57

**Krijimi i një portofoli** 57

**Raportimi dhe komunikimi** 58

**Rishikimi dhe përmirësimi** 58

**Aftësitë e komunikimit** 59

**Shprehja verbale dhe jo-verbale** 59

**Strukturimi i informacionit** 59

**Besimi në vetvete** 60

**Aftësitë e bashkëpunimit** 60

**Menaxhimi i stresit dhe emocioneve** 60

**Vlerësimi dhe reflektimi** 60

**Pjesëmarrje aktive** 61

**Pjesëmarrje në aktivitete jashtë klasës** 61

**Kontribut me burime** 61

**Diskutime në shtëpi** 62

**Vlerësim dhe reflektim** 62

**Krijim i një atmosfere mbështetjeje** 62

Vlerësimi i projektit kurrikular 64

# HYRJE

Përgatitja e mësuesit të arsimit parashkollor për marrjen e kategorive të kualifikimit është një proces i rëndësishëm, i cili përmirësohet dhe pasurohet nga njëri vit në tjetrin sipas zhvillimeve në fushën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe të kualifikimit të mësuesve. Rezultatet e kualifikimit të mësuesve janë tregues të cilësisë së arsimimit dhe të edukimit të shëndetshëm të fëmijëve parashkollorë. Profesioni i mësuesit kërkon përkushtim, përgjegjshmëri dhe standarde të larta pune dhe etike. Mësuesit që marrin vlerësime të larta në procesin e kualifikimit dëshmojnë se zotërojnë njohuri të thelluara mbi pedagogjinë, zhvillimin e fëmijëve dhe metodat e përshtatshme të mësimdhënies, duke siguruar që çdo fëmijë të ketë mundësi për të zhvilluar potencialin e tij të plotë.

Kualifikimi i mësuesve të arsimit parashkollor ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin e fëmijëve dhe në cilësinë e arsimit që marrin. Përmes kualifikimeve të përshtatshme, mësuesit janë në gjendje të krijojnë një mjedis edukativ më të mirë dhe më mbështetës për fëmijët e vegjël. Gjatë viteve të arsimit parashkollor, fëmijët zhvillojnë aftësi themelore si komunikimi, bashkëpunimi, aftësitë motorike dhe mendimi kritik. Mësuesit e kualifikuar kanë aftësinë për të vëzhguar dhe për të ndërhyrë në mënyrën e duhur për të mbështetur zhvillimin e këtyre aftësive, duke ndihmuar fëmijët të bëjnë përparim në të gjitha aspektet e zhvillimit të tyre. Gjithashtu, fëmijët në moshën parashkollore mund të kenë nevoja të ndryshme dhe mësuesit e kualifikuar janë më të aftë për të identifikuar këto nevoja në fazat e hershme, për të ofruar mbështetjen e duhur ose për të rekomanduar ndihmë të specializuar kur është e nevojshme.

Një mjedis i mirëfilltë edukativ është thelbësor për zhvillimin e shëndetshëm të fëmijëve. Mësuesit e kualifikuar dinë të krijojnë një mjedis të sigurt, të ngrohtë dhe stimulues ku fëmijët ndihen të mirëpritur, të mbështetur dhe të motivuar për të mësuar përmes lojës dhe aktiviteteve të tjera të përshtatshme për moshën e tyre.
Kualifikimi i mësuesve është një proces i vazhdueshëm. Mësuesit që kërkojnë të zhvillojnë më tej aftësitë e tyre profesionale janë më të përgatitur për të përballuar sfidat e ndryshimeve në arsim dhe për të siguruar cilësi të lartë në mësimdhënie dhe në arritjet e fëmijëve. Kualifikimi i mësuesve ka ndikim afatgjatë në suksesin e fëmijëve parashkollorë në jetën e tyre akademike dhe personale. Edukimi cilësor në arsimin parashkollor ndihmon në krijimin e një baze të fortë për të mësuarit në të ardhmen, duke i përgatitur fëmijët për të pasur sukses në shkollën fillore.

Mësuesit e kualifikuar kanë aftësi të forta në menaxhimin e klasës dhe në ndërtimin e marrëdhënieve pozitive me fëmijët dhe prindërit. Ata krijojnë një mjedis të rregullt dhe pozitiv ku fëmijët mund të mësojnë dhe të bashkëpunojnë më mirë me njëri-tjetrin.

Pra, mësuesit e kualifikuar rrisin respektin për këtë profesion në arsimin parashkollor. Kualifikimet e duhura ndihmojnë në profesionalizimin e rolit të mësuesit dhe në promovimin e arsimit parashkollor si një nivel i rëndësishëm i sistemit arsimor. Ata veprojnë me ndershmëri dhe integritet të lartë profesional, zotërojnë përmbajtjen e kurrikulës me kompetenca, përditësojnë dijet dhe aftësitë e tyre nëpërmjet trajnimeve dhe kualifikimeve që zhvillojnë, krijojnë dhe pasurojnë vazhdimisht portofolin profesional, përfshihen në procesin e vetëvlerësimit, dokumentojnë vlerësimet që u bëhen, krijojnë marrëdhënie korrekte me prindërit në interesin më të mirë të fëmijëve.

Programi i zhvillimit profesional, për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të arsimit parashkollor, është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen:

- për kandidatët e kategorisë "**Mësues i kualifikuar**", procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet:
  - **dosjes së zhvillimit profesional**;
  - vlerësimit të **aktivitetit të hapur ditor;**
  - vlerësimit me **test të informatizuar**, i cili administrohet dhe monitorohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).
- për kandidatët e kategorisë "**Mësues specialist**", procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet:
  - **dosjes së zhvillimit profesional**;
  - vlerësimit të **aktivitetit të hapur ditor**;
  - vlerësimit të **projektit kurrikular**;
- për kandidatët e kategorisë "**Mësues mjeshtër**", procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet:
  - **dosjes së zhvillimit profesional**;
  - **vlerësimit të projektit kurrikular**.

# SYNIMET DHE QËLLIMET E PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të arsimit parashkollor është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MAS-it Nr.17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë". Ai synon t'u vijë në ndihmë:

- të gjithë mësuesve të arsimit parashkollor për zhvillimin e tyre profesional dhe për marrjen e kategorive të kualifikimit;
- të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar, për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit e arsimit parashkollor që do të hyjnë në këtë proces.

Synimet e programit të zhvillimit profesional të mësuesve të arsimit parashkollor janë:

- *të ndihmojë* çdo mësues që do të kualifikohet për kriteret që duhet të plotësojë dhe procedurat që duhet të ndjekë për të marrë kategorinë e synuar të kualifikimit;
- *të japë* orientime dhe udhëzime që kërkohen nga MAS-i për të ndihmuar të gjithë mësuesit e arsimit parashkollor të krijojnë portofolin e zhvillimit profesional dhe të përgatiten në mënyrë cilësore, për të përballuar me sukses kërkesat e kualifikimit për secilën kategori;
- *të lehtësojë* punën e DRAP-eve, ZVAP-ve, për të organizuar seancat e informimit dhe të trajnimit në lidhje me ndryshimin e procedurave për marrjen e kategorive të kualifikimit "Mësues i kualifikuar", "Mësues specialist" dhe "Mësues mjeshtër".

***Programi ka për qëllim  që mësuesi:***

- të njohë dhe të  zbatojë legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë risitë më të fundit në zhvillimin profesional dhe në sistemin e karrierës;
- të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet e tij profesionale duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efektivitetit të veprimtarisë mësimore-edukative;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për organizimin e mjedisit të klasës, për trajtimin e temave ditore, për nxitjen e bisedave, për zhvillimin e të menduarit kritik dhe krijues, për përdorimin e metodave dhe të veprimtarive që lidhen me përmbushjen e treguesve të standardeve të zhvillimit dhe të të nxënit, për përdorimin e teknikave dhe të formateve të vëzhgimit dhe të vlerësimit të përgjithshëm të zhvillimit të fëmijëve etj.;
- të zotërojë konceptet bazë, ligjësitë shkencore dhe t'i zbatojë me saktësi gjatë mësimdhënies, në përputhje me zhvillimin moshor të fëmijëve 3-6 vjeç;

- të njohë konceptin e gjithëpërfshirjes dhe ta zbatojë në punën e përditshme me fëmijët;
- të trajtojë me fëmijët çështje me prioritet global që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore, pandemitë, krizat ekonomike, antisemitizmin, çështjet e barazisë gjinore etj., me qëllim ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe përgatitjen e tyre për të përballuar sfidat e shoqërisë sot dhe në të ardhmen;
- të demonstrojë rregullat e etikës dhe të komunikimit në punën e tij në kopsht apo pranë shkollës;
- të zbatojë rregullat drejtshkrimore të gjuhës shqipe gjatë veprimtarisë mësimore-edukative;
- të zhvillojë aftësitë e përdorimit të TIK-ut gjatë veprimtarisë mësimore-edukative, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca dhe modelet e arsimit të kombinuar;
- të planifikojë dhe të zhvillojë tema (mësimore) ditore efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënit.

# PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të arsimit parashkollor është i organizuar në tri pjesë:

- *Pjesa e parë*: **Orientime dhe udhëzime për testimin e informatizuar**. Në këtë rubrikë përfshihen, kompetencat profesionale dhe rezultatet e pritshme sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional për realizimin e testit të informatizuar, si edhe modele të pyetjeve me alternativa sipas rubrikave të këtij testimi.
- *Pjesa e dytë*: **Orientime dhe udhëzime për planifikimin dhe zhvillimin e aktivitetit të hapur ditor**. Në këtë pjesë të programit jepen udhëzime rreth formatit të aktivitetit ditor, kërkesat që duhen mbajtur parasysh nga çdo kandidat, si dhe kriteret e vlerësimit të aktivitetit ditor, të cilave do t'u referohen drejtuesi i kopshtit, drejtuesi i rrjetit profesional dhe përfaqësuesi i ZVAP-it.
- *Pjesa e tretë*: **Orientime dhe udhëzime për planifikimin dhe zhvillimin e projektit kurrikular**. Në këtë pjesë të programit jepen udhëzime rreth rubrikave të projektit kurrikular që do të zgjedhin kandidatët për ta zhvilluar me fëmijët e grupit të tyre, si dhe kriteret e vlerësimit të tij, të cilave do t'u referohen drejtuesi i kopshtit, drejtuesi i rrjetit profesional dhe përfaqësuesi i ZVAP-it.

## Orientime dhe udhëzime për testimin e informatizuar – Kategoria "Mësues i kualifikuar"

Testi i informatizuar për mësuesit që synojnë të marrin kategorinë e kualifikimit "Mësues i kualifikuar" përbëhet nga dy pjesë:

a) *Pjesa e parë* përmban pyetje, ushtrime dhe kërkesa që lidhen me zbatimin e programeve mësimore, me pedagogjinë dhe mësimdhënien në arsimin parashkollor, me përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie me mjedisin e të nxënit, me vlerësimin dhe arritjet e fëmijëve, me etikën, komunikimin dhe drejtshkrimin e gjuhës shqipe.

b) *Pjesa e dytë* përfshin pyetje, kërkesa dhe ushtrime që lidhen me zbatimin e përmbajtjes shkencore të kurrikulës së arsimit parashkollor.

## Fushat e testimit të mësuesve – Kategoria "Mësues i kualifikuar"

Fushat në të cilat do të testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve të kategorisë "Mësues i kualifikuar" janë:

- dokumentacioni kurrikular i arsimit parashkollor;
- aspekte të pedagogjisë, të metodologjive të mësimdhënies dhe përdorimit të TIK-ut në arsimin parashkollor;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e kurrikulës së arsimit parashkollor.

Në fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen:

- kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës/lëndës.

| FUSHAT | KOMPETENCAT |
|---|---|
| Dokumentacioni kurrikular i arsimit parashkollor | • Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të dokumentacionit kurrikular të arsimit parashkollor. |
| Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të Tik-ut në mësimdhënien e arsimit parashkollor | • Zotërimi i koncepteve bashkëkohore të mirërritjes dhe të edukimit të fëmijëve parashkollorë.<br>• Përdorimi i metodave aktive të të mësuarit dhe i lojës për zhvillimin tërësor të fëmijëve parashkollorë.<br>• Planifikimi cilësor i veprimtarisë mësimore-edukative duke respektuar nevojat biologjike dhe moshore të fëmijëve parashkollorë dhe regjimin ditor të kopshtit. |

| | |
|---|---|
| | • Përdorimi i instrumenteve të ndryshme të vlerësimit. |
| Aspekte të etikës dhe të komunikimit | • Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit. |
| Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe | • Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. |
| Përmbajtja shkencore e lëndëve të arsimit parashkollor | • Zotërimi i koncepteve dhe i dukurive shkencore dhe transmetimi në mënyrë shkencore dhe didaktike në përshtatje me zhvillimin moshor të fëmijëve parashkollorë. |

Për fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen kompetencat profesionale, si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave. Gjithashtu, programi përmban literaturën rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushave/lëndëve të arsimit parashkollor.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të testimit, do ta ndihmojë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përgatitet për testimin kombëtar për marrjen e kategorisë "Mësues i kualifikuar".

| FUSHA "DOKUMENTACIONI KURRIKULAR" | |
|---|---|
| **Kompetenca**<br>**"Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të dokumentacionit kurrikular të arsimit parashkollor"** | **Literatura e rekomanduar** |
| **Rezultatet e pritshme**<br>*Mësuesi i arsimit parashkollor:* | • Korniza Kurrikulare e Arsimit Parashkollor, MAS 2017.<br>• Standardet e zhvillimit dhe të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç, MAS 2017. |

| | |
|---|---|
| • *qëndron* i mirinformuar për të rejat e reformës kurrikulare, pjesë e të cilës është edhe arsimi parashkollor;<br>• *analizon* dhe *bën* interpretime për standardet e zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç;<br>• *zbaton* kërkesat e programeve të reja të arsimit parashkollor;<br>• *bën* planifikime kurrikulare mbi bazën e karakteristikave të zhvillimit të përgjithshëm të fëmijëve të moshës 3-6-vjeçare. | • Programet e arsimit parashkollor për 3-4-vjeçarët, MAS 2017.<br>• Programet e arsimit parashkollor për 4-5-vjeçarët, MAS 2018.<br>• Programi i arsimit parashkollor për 5-6-vjeçarët, MAS 2019.<br>• Korniza e vlerësimit në arsimin parashkollor, MAS 2019.<br>• Literaturë që ka në fokus aspekte të ndryshme të përmbajtjes, analizës, zbatimit të kurrikulës së parashkollorit. |

| **FUSHA "ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut NË ARSIMIN PARASHKOLLOR"** | |
|---|---|
| **Kompetenca I**<br>**"Zotërimi i koncepteve bashkëkohore të mirërritjes dhe të edukimit të fëmijëve parashkollorë"** | **Literatura e rekomanduar** |
| **Rezultatet e pritshme**<br>*Mësuesi i arsimit parashkollor:*<br>• *është* njohës i mirë i aspekteve psikologjike dhe pedagogjike që i përkasin fëmijërisë së hershme;<br>• *është* njohës i mirë i standardeve të fushës së zhvillimit të përgjithshëm fizik të fëmijës 3-6 vjeç;<br>• *është* njohës i mirë i standardeve të fushës së zhvillimit gjuhësor të fëmijës 3-6 vjeç;<br>• *është* njohës i mirë i standardeve të fushës së zhvillimit intelektual të fëmijës 3-6 vjeç; | • Standardet e zhvillimit dhe të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç.<br>• Korniza Kurrikulare e arsimit parashkollor, MAS 2017.<br>• Korniza e vlerësimit të cilësisë së kopshtit dhe Udhëzuesi metodologjik për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të kopshtit, Urdhri i MAS-it, Nr.199, datë 07.05.2024, MAS.<br>• Literaturë që ka në fokus koncepte bashkëkohore të edukimit të fëmijëve |

<table>
<tr><td>

- *është* njohës i mirë i standardeve të fushës së zhvillimit social-emocional të fëmijës 3-6 vjeç;
- *menaxhon* situata, sjellje dhe veprime të ndryshme fëmijësh;
- *përzgjedh* dhe përshtat lojëra për secilën fushë zhvillimi;
- *dallon* nëse një fëmijë paraqet vështirësi në të nxënë, është me aftësi të kufizuara ose ka nevoja të veçanta;
- *harton* plan edukativ individual (PEI) për fëmijët me aftësi të kufizuar.

</td><td>parashkollorë dhe të mësimdhënies në këtë grup-moshë.</td></tr>
<tr><th>Kompetenca II<br><br>“Përdorimi i metodave aktive të të mësuarit dhe i lojës për zhvillimin tërësor të fëmijëve parashkollorë”</th><th>Literatura e rekomanduar</th></tr>
<tr><td>

**Rezultatet e pritshme**

*Mësuesi i arsimit parashkollor:*

- *është* njohës i mirë i aspekteve pedagogjike dhe didaktike të mësimdhënies dhe të nxënit në moshën parashkollore;
- *është* njohës i mirë i stileve të të nxënit;
- *krijon* në kopsht një mjedis nxitës dhe motivues sipas treguesve cilësorë;
- *organizon* projekte dhe mini projekte me tematika të caktuara;
- *planifikon* veprimtari që nxisin aftësitë krijuese të fëmijëve;
- *vlerëson* rolin e lojës si veprimtaria kryesore nëpërmjet të cilës fëmijët parashkollorë zhvillohen dhe mësojnë;

</td><td>

- Standardet e zhvillimit dhe të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç.
- Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit të arsimit parashkollor, MAS 2018.
- Literaturë që ka në fokus koncepte bashkëkohore të edukimit të fëmijëve parashkollorë dhe të mësimdhënies në këtë moshë.

</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| • *përdor* metodat aktive të të mësuarit, duke pasur fëmijën në qendër;<br>• prezanton materiale mësimore duke përdorur programe të përshtatshme si Power Point;<br>• përdor materiale nga website zyrtare, platforma online si Youtube, si dhe aplikacione të thjeshta, nëpërmjet të cilave demonstron aspekte të ndryshme mësimore. | |
| **Kompetenca III**<br>**“Planifikimi cilësor i veprimtarisë mësimore-edukative duke respektuar nevojat biologjike dhe moshore të fëmijëve parashkollorë dhe regjimin ditor të kopshtit”** | **Literatura e rekomanduar** |
| **Rezultatet e pritshme**<br>*Mësuesi i arsimit parashkollor:*<br>• *planifikon* veprimtari mësimore-edukative sipas veçorive psiko-pedagogjike të kësaj moshe (3-6 vjeç);<br>• *zbaton* praktika pedagogjike në përshtatje me planifikimin mujor, javor dhe ditor;<br>• *zhvillon* forma dhe lloje të ndryshme veprimtarish të alternuara si: në grup të madh, në grup të vogël dhe individuale;<br>• *zhvillon* forma dhe lloje të ndryshme veprimtarish të alternuara si: të lira, të sugjeruara dhe të drejtuara;<br>• *zhvillon* forma dhe lloje të ndryshme veprimtarish të alternuara, në ato që kërkojnë përqendrim e vëmendje apo çlodhëse; | • Korniza e vlerësimit të cilësisë së kopshtit dhe Udhëzuesi metodologjik për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të kopshtit, Urdhri i MAS-it, Nr.199, datë 07.05.2024, MAS.<br>• Literaturë që ka në fokus koncepte bashkëkohore të edukimit të fëmijëve parashkollorë dhe të mësimdhënies në këtë moshë.<br>• Urdhër për miratimin e “Standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”, nr. 84 datë 06.05.2021. |

| | |
|---|---|
| • *zhvillon* forma dhe lloje të ndryshme veprimtarish të alternuara, që zhvillohen në mjedise të ndryshme (ulur, në këmbë, në pozicion çlodhës, në të njëjtin vend apo në vende të ndryshme), në një mjedis tjetër të kopshtit, brenda apo jashtë kopshtit;<br>• *zhvillon* forma dhe lloje të ndryshme veprimtarish të alternuara si: të udhëhequra nga mësuesja e grupit apo të udhëhequra nga një person tjetër (prindi);<br>• *zbaton* kohëzgjatjen e veprimtarive duke sugjeruar përdorimin e këndeve dhe lodrave, në funksion të moshës së fëmijëve;<br>• *zbaton* veprimtari individuale vëzhguese, duke dalluar shenjat e dukshme të lodhjes, të mungesës së interesit etj. | |
| **Kompetenca IV**<br>**"Përdorimi i instrumenteve të ndryshme të vlerësimit"** | **Literatura e rekomanduar** |
| **Rezultatet e pritshme**<br>*Mësuesi i arsimit parashkollor:*<br>• vlerëson rolin e lojës si veprimtaria kryesore nëpërmjet të cilës fëmijët parashkollorë zhvillohen, mësojnë, por edhe vlerësohen;<br>• përdor instrumente të ndryshme vëzhgimi dhe vlerësimi;<br>• mban shënime për ecurinë, përfshirjen dhe përparimin e fëmijëve. | • Korniza e vlerësimit në arsimin parashkollor, MAS 2019.<br>• Korniza e vlerësimit të cilësisë së kopshtit dhe Udhëzuesi metodologjik për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të kopshtit, Urdhri i MAS-it, Nr.199, datë 07.05.2024, MAS. |

| FUSHA "ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT" | |
|---|---|
| **Kompetenca "Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit"** | **Literatura** |
| **Rezultatet e pritshme**<br>*Mësuesi i arsimit parashkollor:*<br>• *njeh* rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesin e institucionit arsimor, me kolegët, me stafin ndihmës dhe mbështetës, fëmijët, prindërit dhe komunitetin;<br>• *sillet* në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesin e institucionit arsimor, me kolegët, me stafin ndihmës dhe mbështetës, fëmijët, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. | • Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar.<br>• Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit të arsimit parashkollor, MAS 2018.<br>• Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr. 31, datë 28.01.2020. |

| FUSHA "ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE" | |
|---|---|
| **Kompetenca "Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe"** | **Literatura** |
| **Rezultatet e pritshme**<br>*Mësuesi i arsimit parashkollor:*<br>• *zbaton* rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe, në të folur, në të lexuar dhe në të shkruar;<br>• *zbaton* rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe në çdo veprimtari në institucionin arsimor. | • Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. |

| FUSHA “PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËVE TË ARSIMIT PARASHKOLLOR” | |
| --- | --- |
| **Kompetenca “Zotërimi i koncepteve dhe i dukurive shkencore, transmetimi në mënyrë shkencore dhe didaktike në përshtatje me zhvillimin moshor të fëmijëve parashkollorë”** | **Literatura** |
| *Mësuesi i arsimit parashkollor:*<br>• *zotëron* koncepte shkencore, dukuritë, ligjësitë që trajtohen në arsimin parashkollor në nivel shkencor dhe didaktik;<br>• *transmeton* te fëmijët parashkollorë ato njohuri, shprehi, aftësi dhe vlera që janë në përputhje me zhvillimin e tyre dhe me kërkesat e programeve;<br>• *përmbush* kërkesat e secilës fushë kurrikulare dhe i transmeton saktësisht te fëmijët nga ana shkencore. | • Standardet e zhvillimit dhe të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç, MAS 2018.<br>• Korniza Kurrikulare e Arsimit Parashkollor, MAS 2017.<br>• Programet e arsimit parashkollor për 3-4- vjeçarët, MAS 2017.<br>• Programet e arsimit parashkollor për 4-5- vjeçarët, MAS 2018.<br>• Programi i arsimit parashkollor për 5-6- vjeçarët, MAS 2019.<br>• Botime ndihmëse, buletine, enciklopedi dhe materiale të tjera burimore që trajtojnë përmbajtjen shkencore të fushave të ndryshme kurrikulare të arsimit parashkollor. |

## Modele pyetjesh me alternativa

Testi i informatizuar përmban vetëm pyetje me alternativa. Pyetjet i përkasin kurrikulës së arsimit parashkollor, mësimdhënies dhe të nxënit, vlerësimit të fëmijëve, përmbajtjes shkencore, etikës, komunikimit dhe drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

**B. Modele pyetjesh për dokumentacionin kurrikular të arsimit parashkollor**

**Pyetja 1.**

Në fokus të cilës tematikë janë konceptet: *unë, ti, familja, klasa, nevoja, dëshira, rregulla, sjellje, dallimi, e përbashkëta, përgjegjësi dhe respekt*?

A) Individët, grupet, shoqëria.
B) Kultura.
C) Ndërvarësia ndërmjet njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve.
D) Kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia.

**Pyetja 2.**

"Prezantimi i vetes me fjalë të thjeshta" sipas kompetencës "Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar" është:

A) Njohuri
B) Shkathtësi
C) Vlerë
D) Aftësi

**Pyetja 3.**

Cila nga këto kompetenca i përket fushës së shkencave të natyrës?

A) Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre.
B) Arsyetimi dhe komunikimi matematikor.
C) Të folurit për të komunikuar dhe mësuar.
D) Ndërveprimi me të tjerët në situata lëvizore.

**Pyetja 4.**

Cilës nga kompetencat kyçe i përket rezultati "Fëmija parashkollor përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët dhe përgatitet të veprojë si qytetar i përgjegjshëm"?

A) Kompetencës personale.
B) Kompetencës qytetare.
C) Kompetencës digjitale.
D) Kompetencës së të mësuarit.

**Pyetja 5.**

"Arsimi është përgjegjësi e përbashkët e mësuesve, e prindërve, e specialistëve dhe e shoqërisë". Cilit nga parimet e kurrikulës i përket?

A) Autonomia dhe fleksibiliteti.
B) Bashkëpunimi dhe partneriteti.
C) Baraspesha dhe integrimi.
D) Respekti për të ndryshmen.

**C. Modele pyetjesh për aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në arsimin parashkollor**

**Pyetja 6.**

Respektimi i kulturave të të tjerëve i përket:

A) metodës së bazuar në lojë;
B) metodës multikulturore;
C) metodës së bazuar në projekte;
D) metodës së bazuar në integrimin tematik.

**Pyetja 7.**

Fëmijët e grupit të tretë diskutojnë rreth garave me makina. Përgjatë diskutimit, lind një debat pasi djemtë mendojnë që vajzat nuk mund të jenë shofere në garat me makina. Situata e mësipërme krijon mundësi për të folur për:

A) stereotipet gjinore;
B) identitetin gjinor;
C) rolet gjinore;
D) diskriminimin gjinor.

**Pyetja 8.**

Mësuesja u bën të ditur paraprakisht fëmijëve çfarë do të vëzhgojnë në rastet kur:

A) tregon një histori me figura;
B) bën një demonstrim në klasë;
C) nxjerr fëmijët në ekskursion;
D) shpjegon një koncept matematikor.

**Pyetja 9.**

Nëse fëmija bën mbledhje dhe zbritje, cilën nga aftësitë e mëposhtme po zhvillon?

A) Mbledh informacion rreth botës së gjallë.
B) Mbledh informacion për mjedisin, natyrën.
C) Shfaq interes për numrat dhe numërimin.
D) Përfshihet në procesin e eksplorimit shkencor.

**Pyetja 10.**

Cilën prej aktiviteteve kryen mësuesja kur shpjegon për një fëmijë 3-4 vjeçar karakteristikat e botës së gjallë?

A) Emërton mjediset që sheh në natyrë (malin, fushën, lumin).
B) Emërton stinët në mënyrë korrekte sipas radhës (pranverë, verë, vjeshtë, dimër).
C) Bën pyetje rreth elementit të jetës (tokës, ujit, ajrit, zjarrit).
D) Emërton dhe dallon pjesë të ndryshme të kohës (ditën, natën, ditët e javës, muajt, stinët).

**Pyetja 11.**

Nëse mësuesja ka zgjedhur si strategji “Ekskursion për të vëzhguar natyrën në stinën e dimrit”, fëmijët po realizojnë një aktivitet që i përket:

A) fushës së zhvillimit matematikor;
B) fushës së zhvillimit gjuhësor;
C) fushës së zhvillimit shkencor;
D) fushës së zhvillimit social.

**Pyetja 12.**

Si vepron mësuesja, nëse një fëmijë nuk dëshiron të marrë pjesë në një lojë ku janë pjesëmarrës të gjithë fëmijët e tjerë?

A) E detyron të luajë.
B) Kërkon shpjegim.
C) E provon më vonë.
D) Ndryshon lojën.

**Pyetja 13.**

Teoria e “Motivacionit njerëzor” bazuar në nevojat e individit është teori e:

A) Piazhesë
B) Vigotskit
C) Maslow-t
D) Eriksonit

**Pyetja 14.**

Duke pasur parasysh metodologjitë e të nxënit, cilës metodë i përket një program i integruar me një temë të unifikuar, ku fëmija dhe mësuesi janë të dy të integruar?

A) Metoda e bazuar në lojë.
B) Metoda e përqendruar tek fëmija.
C) Metoda e bazuar te integrimi tematik.
D) Metoda e bazuar në projekte.

## D. Modele pyetjesh për aspekte të komunikimit dhe etikës

**Pyetja 15.**

Diversiteti dhe larmia etnike dhe kulturore në komunitetin e një klase apo kopshti duhet të shihet si:

A) burim i mundshëm konfliktesh ndërmjet fëmijëve;
B) gjendje e përkohshme deri në sheshimin e kësaj larmie;
C) vlerë që duhet të vlerësohet, të zhvillohet dhe të ruhet;
D) problem që duhet të zgjidhet me strategji të posaçme.

**Pyetja 16.**

Një nga fëmijët është i shqetësuar në kopsht. Cila është mënyra më e mirë e komunikimit që mësuesi të qetësojë fëmijën?

A) Rri indiferent ndaj shqetësimit të fëmijës.
B) E përfshin dhe inkurajon më shumë në aktivitete që të ndihet mirë në ambientin e grupit/ klasës.
C) Diskuton me të gjithë fëmijët rreth shqetësimit të tij.
D) Zbaton masa disiplinore.

**Pyetja 17.**

Sipas Kodit të Etikës:

A) mësuesi ka për detyrë të njohë të gjitha format e mundshme të dhunës (fizike, psikologjike etj.) ndaj fëmijëve/nxënësve;
B) mësuesi nuk ka për detyrë të njohë të gjitha format e mundshme të dhunës (fizike, psikologjike etj.) ndaj fëmijëve/nxënësve;
C) mësuesi ka për detyrë të njohë disa nga format e mundshme të dhunës (fizike, psikologjike etj.) ndaj fëmijëve/nxënësve;
D) mësuesi përpiqet të ofrojë aq sa mundet për fëmijët/nxënësit e tij dhe pranon se kontributi i tyre nuk mjafton në përvetësimin e njohurive.

**Pyetja 18.**

Një nga qëllimet e Kodit të Etikës është të ndihmojë:

A) fëmijën/nxënësin në krijimin e një mjedisi motivues për të nxënit;
B) mësuesin në krijimin e një mjedisi motivues për të nxënit;
C) bordin në krijimin e një mjedisi motivues për të nxënit;
D) komunitetin në krijimin e një mjedisi motivues për të nxënit.

## E. Modele pyetjesh për aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

**Pyetja 19.**

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

A) grupi 2-të në arsimin parashkollor;
B) grupi i 2 në arsimin parashkollor;
C) grupi i 2-t në arsimin parashkollor;
D) grupi i 2-të në arsimin parashkollor.

**Pyetja 20.**

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

A) vendim marrje
B) vendimmarrje
C) vendimarrje
D) vendimmarje

**Pyetja 21.**

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

A) mikro organizëm;
B) mikroorganizëm;
C) mikroorganizëm;
D) mikro organizmë.

**Pyetja 22 Pyetja**

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

A) një milion e pesë qind mijë e dyqind e trembëdhjetë;
B) një milion e pesëqindmijë e dyqind e trembëdhjetë;
C) një milion e pesëqind mijë e dyqind e trembëdhjetë;
D) një milion e pesëqind mijë e dy qind e trembëdhjetë.

**F. Modele pyetjesh për përmbajtja shkencore të lëndëve në arsimin parashkollor**

**Pyetja 23.**

Për të zhvilluar të folurin, fëmijëve u kërkohet që pëlqimet rreth ngjarjeve ose personazheve të tekstit t'i shprehin me :

A) fjali të thjeshta;
B) gjeste dhe veprime jo verbale;
C) lojë në role;
D) vizatim.

**Pyetja 24.**

Përcaktimi i vendndodhjes së një objekti bëhet duke:

A) përdorur termat para, lart, mbi, majtas, ndërmjet, afër, brenda etj.;
B) lëvizur në drejtime të caktuara;
C) përdorur imagjinatën;
D) vizatuar me dorë të lirë.

**Pyetja 25.**

Çfarë tregon një fëmijë kur bën gjëra për të kënaqur të rriturin?

A) Tregon se ndihet mirë.
B) Kërkon tërheqjen e vëmendjes.
C) I pëlqen të shfaqë veten.
D) Tregon çfarë i pëlqen të bëjë.

**Pyetja 26.**

Eksperimenti me hedhjen e objekteve me peshë të ndryshme në ujë ka lidhje me:

A) notimin dhe zhytjen e trupave;
B) ndikimin e njeriut mbi trupat;
C) ndërveprimin e trupave;
D) ndryshimin e formës së trupave.

**Pyetja 27.**

Lëvizje lokomotore janë:

A) ecja, vrapimi, kërcimi;
B) shtytja, ekuilibrimi, rrotullimi;
C) pritja, goditja, zhonglimi;
D) qëndrimi i shtyllës kurrizore në vend dhe në lëvizje.

**Pyetja 28.**

Cicërima e zogut, fëshfërima e gjetheve, gurgullima e ujit janë tinguj që:

A) ndeshen në mjedisin rrethues;
B) prodhohen duke luajtur me zërin;
C) lëshojnë instrumentet muzikore;
D) prodhohen në natyrë.

**Pyetja 29.**

Çfarë njohurish u ofrojmë fëmijëve kur u shpjegojmë regjimin ditor në kopsht?

A) Të përbashkëtat dhe dallimet mes ditës dhe natës.
B) Karakteristikat e ditës dhe veprimet që zhvillojmë gjatë saj.
C) Rëndësinë e ditës dhe të natës në jetën e njeriut.
D) Rëndësinë e ditës në proceset jetësore të gjallesave.

**Pyetja 30.**

Kur fëmija sillet me mirësi dhe butësi ndaj kafshëve dhe bimëve, mbështet bashkëmoshatarët që vriten ose janë të shqetësuar, mbështet familjarët ose miqtë që nuk ndjehen mirë, ai/ajo:

A) shfaq empati përkundrejt të tjerëve;
B) përshtatet në mjedise të ndryshme;
C) shpreh në mënyrën e duhur sjelljen dhe emocionet;
D) kupton sjellje të ndryshme dhe ndikimin e tyre.

**Pyetja 31.**

Realizohet me shabllone të gatshme:

A) vizatimi
B) modelimi me plastelinën
C) piktura
D) stampimi

**Pyetja 32.**

Cili vit u emërtua si viti i Skënderbeut?

A) 2016
B) 2017
C) 2018
D) 2019

**Pyetja 33.**

Nga rrotullimi i Tokës rreth Diellit formohen:

A) Ditët
B) Muajt
C) Stinët
D) Viti

**Pyetja 34.**

Kur diskutojmë se si ndryshon një bimë në faza të ndryshme të zhvillimit kemi për qëllim të trajtojmë:

A) Ciklin jetësor të bimëve.
B) Rëndësinë e ujit për gjallesat.
C) Procesin e fotosintezës te bimët.
D) Si mbillet një bimë.

**Pyetja 35.**

Cili tekst i takojnë përrallat?

A) Poetik
B) Dramatik
C) Tregimtar
D) Përshkrues

**Pyetja 36.**

Në një shportë me fruta të ndryshme fëmija duhet të përcaktojë numrin e mollëve të kuqe. Cila aftësi e të nxënit i zhvillohet fëmijës?

A) E numërimit
B) E klasifikimit
C) E grupimit
D) E renditjes

**Pyetja 37.**

Barazia gjinore, si parim kuptohet si:

A) kalim nga stereotipi drejt barazisë.
B) ekzistencë e ndryshimeve gjinore.
C) përshtatje e mënyrës së të jetuarit.
D) respekt ndaj besimit të të tjerëve.

## Orientime dhe udhëzime për planifikimin dhe zhvillimin e aktivitetit të hapur ditor - Kategoria "Mësues i kualifikuar" dhe "Mësues specialist"

Sipas Nenit 8 të Udhëzimit të MAS-it Nr.17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë" ora mësimore e hapur, e cila në arsimin parashkollor përkthehet në aktivitet ditor, duhet të ketë krijimtari, risi, profesionalizëm, gjithëpërfshirje dhe efektivitet. Mësimdhënia në kopsht ka specifika referuar moshës së fëmijëve dhe zhvillohet e gjitha nëpërmjet bisedave, demonstrimeve, situatave, lojërave dhe veprimtarive praktike. Fëmijët mësojnë në mënyra të ndryshme, por loja dhe eksplorimi mbeten veprimtaritë kryesore prej të cilave ata mësojnë koncepte dhe njohuri për botën që i rrethon. Në arsimin parashkollor, mësimi nuk është i ndërtuar me orë të veçanta mësimi, por si një aktivitet ditor, i cili realizohet gjatë gjithë kohës së qëndrimit të fëmijëve në kopsht. Brenda temës së aktivitetit ditor, mësuesi integron njohuri nga të gjitha lëndët që ka parashikuar të zhvillojë gjatë ditës, të cilat zhvillohen me mënyra dhe aktivitete të larmishme.

Mësimdhënia dhe të nxënit me kompetenca kërkon mësues cilësisht të aftë për të përmbushur zhvillimin e përgjithshëm dhe të nxënit e fëmijëve, të përkushtuar ndaj interesave e nevojave të tyre, për të përzgjedhur lojëra, veprimtari, mjete dhe burime të përshtatshme për ta bërë procesin e të nxënit sa më efektiv. Në aktivitetin ditor që do të zhvillojë, mësuesi i arsimit parashkollor do të demonstrojë se:

- zotëron përmbajtjen e dokumenteve të kurrikulës me kompetenca;
- zbaton kurrikulën gjithëpërfshirëse e të integruar, të mbështetur në zhvillimin e përgjithshëm dhe në përputhje me nevojat, interesat dhe mundësitë e të gjithë fëmijëve të grupit;
- planifikon dhe zhvillon mësimdhënien bazuar në zhvillimin moshor të fëmijëve, në teoritë e zhvillimit të të nxënit dhe sipas kërkesave të kurrikulës zyrtare;
- njeh natyrën e rritjes, të zhvillimit dhe të aftësive për të nxënë të fëmijëve 3-6 vjeç;
- ndikon në zhvillimin cilësor të të gjitha marrëdhënieve brenda klasës, duke pranuar dhe marrë në konsideratë interesat individuale të fëmijëve, aftësitë dhe stilet e ndryshme të të nxënit;
- respekton ndryshimet ndërmjet individëve dhe nevojat e tyre të veçanta duke i trajtuar të gjithë fëmijët në mënyrë të barabartë, të drejtë dhe dinjitoze;

- siguron hapësira të kënaqshme që përmbushin kriteret për shëndetin dhe edukimin fizik të fëmijëve;
- zhvillon veprimtari nëpërmjet të cilave fëmijët mësojnë, luajnë, kërkojnë, zbulojnë, krijojnë, zhvillojnë aftësitë e tyre, zgjidhin probleme, mësojnë të bëjnë zgjedhje, mësojnë të marrin vendime, të bashkëpunojnë, të komunikojnë, të bisedojnë me të tjerët, të mësojnë të respektojnë njëri-tjetrin dhe rregullat e grupit;
- krijon në klasë një mjedis pozitiv, paqësor, mikpritës dhe gjithëpërfshirës, të sistemuar nga ana fizike dhe me lehtësi për t'u shfrytëzuar nga fëmijët në çdo veprimtari ditore;
- përshtat mjedisin e klasës në mënyrë të tillë që të lehtësojë zhvillimin dhe të nxënit e fëmijëve;
- përdor metoda, praktika dhe burime të larmishme për të nxitur zhvillimin individual, të nxënit dhe bashkëpunimin reciprok;
- është njohës dhe përdorues i mirë i programeve të kompjuterit, *i site*-ve të internetit dhe i përdor kur është e nevojshme në procesin e të nxënit;
- mundet të zhvillojë mësimdhënie multimediale, duke përdorur teknologji të reja që nxitin efektivitetin e të nxënit tek fëmijët;
- i dëgjon dhe i vëzhgon fëmijët gjatë kryerjes së punimeve, lojërave dhe veprimtarive të ndryshme;
- njeh pikat e forta, dobësitë, vështirësitë dhe nevojat e çdo fëmije dhe i mban parasysh në planifikimin e veprimtarive didaktike e mësimore;
- përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vëzhgon, monitoron dhe dokumenton sjelljet dhe veprimtaritë e fëmijëve.

## Orientime rreth planifikimit të aktivitetit të hapur ditor

Mësuesi është i lirë ta zgjedhë vetë temën ditore, të cilën do ta zhvillojë me fëmijët e grupit të tij gjatë aktivitetit ditor. Gjithashtu, ai është i lirë ta zgjedhë vetë edhe mjedisin ku do ta zhvillojë mësimin me fëmijët gjatë asaj dite. Mësuesi do të vlerësohet:

- për respektimin e rubrikave të formatit të planifikimit ditor;
- për zbatimin praktik të këtij plani me fëmijët e grupit.

Gjatë trajnimeve për zbatimin e kurrikulës së re, mësuesit janë njohur edhe me formatin e ri të planifikimit vjetor, planifikimit të periudhës dhe planifikimit të aktivitetit ditor.
Në vijim jepen orientime si për planifikimin e aktivitetit ditor, ashtu edhe për zbatimin e tij.

Formati për planifikimin ditor sipas kurrikulës me kompetenca përmban rubrika të përcaktuara. Mësuesi është i lirë t'i organizojë këto rubrika në mënyrën që i duken më efektive. Në vijim renditen të gjitha rubrikat dhe jepen orientime/ udhëzime që do ta ndihmojnë mësuesin të bëjë një planifikim sa më të mirë të aktivitetit ditor, duke përfshirë risitë metodologjike për realizimin e rezultateve të të nxënit, si dhe risitë në procesin e të nxënit.

**Rubrikat e planifikimit të aktivitetit ditor**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema ditore** | ➦ | Mësuesi shkruan temën ditore, të cilën e ka parashikuar në planifikimin javor dhe mujor. |
| **Temat sipas lëndëve** | ➦ | Në varësi të temës ditore, mësuesi përzgjedh lëndët që do të integrohen brenda saj. Për secilën lëndë ai cakton temën e mësimit, e cila lidhet me një njohuri ose koncept lëndor. |
| **Rezultatet e të nxënit** | ➦ | Mësuesi shkruan 1-2 rezultate të nxëni për secilën nga lëndët mësimore që do të zhvillojë gjatë ditës. Rezultatet e të nxënit duhet të jenë *specifike*, *të matshme*, të arritshme dhe *të kuptueshme* për atë që pritet të demonstrohet nga fëmijët. |
| **Konceptet kyç/ fjalët kryesore** | ➦ | Mësuesi do të shkruajë konceptet kyç apo fjalët kryesore që do të trajtohen/përmenden gjatë veprimtarisë ditore. Numri i tyre është i lidhur me temat mësimore lëndore. |

| | | |
|---|---|---|
| **Burimet, materialet dhe mjetet didaktike** | ➦ | Mësuesi shënon burimet, materialet dhe mjetet didaktike[1] që do t'i përdorë ai dhe fëmijët gjatë prezantimit të temës ditore dhe në veprimtaritë e mëtejshme gjatë ditës. |
| **Ecuria ditore - Metodologjia dhe veprimtaritë mësues-fëmijë** | ➦ | Mësuesi shënon hap pas hapi procedurën që do të ndjekë gjatë trajtimit të temës ditore, për të gjitha veprimtaritë që do të zhvillohen prej tij dhe prej fëmijëve. Ai do të përshkruajë metodat që do të përdorë, mjetet digjitale, qendrat që do të hapë dhe veprimtaritë që do të kryejë në to.<br>Gjithashtu, mësuesi do të përcaktojë instrumentet e vëzhgimit dhe të vlerësimit të fëmijëve, për mënyrën dhe procesin e përmbushjes së rezultateve të të nxënit nga fëmijët. |

Sipas Nenit 25 të Udhëzimit të MAS-it Nr.17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë", vlerësimi i orës mësimore (në rastin e arsimit parashkollor të aktivitetit ditor) për kandidatët e kategorisë "Mësues i kualifikuar" (Shtojca nr.1) dhe të kategorisë "Mësues specialist" (Shtojca nr.2) bëhet sipas Formatit të instrumentit për vlerësimin e orës së hapur, i cili përmban; treguesit e cilësisë, përshkruesit, totalin e pikëve për secilin përshkrues dhe nivelet e vlerësimit.

[1] Në çdo program lëndor të arsimit parashkollor ka një rubrikë të veçantë "Materiale dhe burime mësimore" që duhen mbajtur parasysh nga mësuesi gjatë planifikimeve ditore. Gjithashtu, në "Kornizën kurrikulare të arsimit parashkollor" ka një kapitull të veçantë që lidhet me qendrat/këndet e veprimtarive, në të cilat zhvillohen aktivitete të ndryshme dhe përdoren materiale të përshtatshme për realizimin e tyre.

## Udhëzime për plotësimin e Formatit të instrumentit për vlerësimin e aktivitetit ditor për "Mësuesin e kualifikuar" (Shtojca nr.1) dhe për "Mësuesin specialist" (Shtojca nr.2)

**Treguesi 1: Planifikimi i aktivitetit ditor**

**Përshkruesi 1. Mësuesi e ka planifikuar aktivitetin ditor sipas rubrikave të përcaktuara, në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të të nxënit**

Mësuesi vlerësohet për:

- përmbushjen e kritereve të shkrimit të rezultateve të të nxënit të temës së mësimit;
- përshtatjen e situatës së të nxënit me përmbajtjen e temës së mësimit;
- për përzgjedhjen e materialeve dhe të mjeteve të përshtatshme për temën e mësimit;
- për qartësinë e hapave që do të ndjekë për zhvillimin e aktivitetit ditor;
- mbajtjen parasysh të stileve të ndryshme të të nxënit.

**Përshkruesi 2: Mësuesi ka planifikuar për aktivitetin ditor qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës, krahas kompetencave lëndore**

Mësuesi vlerësohet për:

- qasjen e re inovative që ka sjellë në zhvillimin e aktivitetit ditor;
- veprimtaritë që lidhen me zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës;
- veprimtaritë që lidhen me zhvillimin e kompetencave lëndore.

**Treguesi 2: Mjedisi i të nxënit**

**Përshkruesi 1. Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, dhe një mjedis ku fëmijët trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri-tjetrin**

Mësuesi vlerësohet për:

- klimën që ka krijuar në klasë, ndërmjet tij dhe fëmijëve të grupit dhe ndërmjet fëmijëve në marrëdhënie me njëri-tjetrin;
- lirshmërinë që kanë fëmijët për të shfaqur mendimet dhe idetë e tyre për pyetje, situata dhe veprimtari të ndryshme;

- komunikimin dhe marrëdhëniet që kanë fëmijët ndaj njëri-tjetrit në situata, momente dhe veprimtari të ndryshme që zhvillohen në kopsht.

**Përshkruesi 2. Mësuesi krijon një mjedis të përshtatshëm për përfshirjen e fëmijëve në veprimtari, në bashkëpunime në nisma e ndërveprime të ndryshme**

Mësuesi vlerësohet për:

- drejtimin në emër të çdo fëmije të klasës;
- përfshirjen e të gjithë fëmijëve gjatë aktivitetit ditor;
- përgjigjet që u jep pyetjeve të fëmijëve;
- vëmendjen që i kushton çdo fëmije që ka nevojë;
- qetësinë që ruan në situata të vështira që kanë ndodhur gjatë aktivitetit ditor;
- përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe të fëmijëve që paraqesin vështirësi në të nxënë.

**Treguesi 3: Metodat mësimore**

**Përshkruesi 1. Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues dhe diskutimin ndërmjet fëmijëve**

Mësuesi vlerësohet për:

- përdorimin e metodave dhe të teknikave që nxisin të menduarit kritik të fëmijëve;
- përdorimin e metodave që nxisin zgjidhje origjinale dhe stimulojnë aftësitë krijuese të fëmijëve;
- temat, çështjet dhe rastet që sjellë para fëmijëve, të cilat nxisin biseda, diskutime dhe shprehjen e mendimeve të ndryshme;
- mundësitë që i jep çdo fëmije për të kryer me sukses veprimtaritë e planifikuara.

**Përshkruesi 2. Mësuesi drejton pyetje të llojeve të ndryshme dhe nxit fëmijët të përgjigjen dhe të bëjnë edhe ata pyetje**

Mësuesi vlerësohet për:

- cilësinë e pyetjeve që u drejton fëmijëve;
- larminë e pyetjeve, mbështetur në Taksonominë e Blumit, por jo vetëm;
- nxitjen e fëmijëve për të bërë pyetje rreth asaj që dëgjojnë;
- kohën që u lë fëmijëve të përgjigjen në varësi të llojit/ nivelit të pyetjes që bëhet.

**Treguesi 4: Vlerësimi i fëmijëve**

**Përshkruesi 1. Mësuesi vëzhgon për të identifikuar nevojat për përmirësim të fëmijëve të grupit dhe lehtëson procesin e tyre të të nxënit**

Mësuesi vlerësohet për:

- përmbushjen e rezultateve të të nxënit nga ana e fëmijëve;
- mundësitë që iu krijuan çdo fëmije për të treguar se çfarë mësoi nga aktiviteti ditor;
- qartësinë e fëmijëve në kryerjen e detyrave dhe përfshirjen e tyre në zhvillimin e veprimtarive gjatë aktivitetit ditor;
- analizën që bën në lidhje me arritjet e fëmijëve.

**Përshkruesi 2. Mësuesi përfshin fëmijët në veprimtari të diferencuara sipas nevojave të tyre**

Mësuesi vlerësohet për:

- përshtatjen e mësimdhënies dhe të veprimtarive sipas nevojave të fëmijëve;
- përfshirjen e fëmijëve në veprimtari, të cilat ata mund t'i kryejnë dhe të përmbushin rezultatet e të nxënit.
- përshtatjen e teknikës së vlerësimit me veprimtarinë për të cilën bëhet vlerësimi i fëmijës;
- motivimin e fëmijëve për t'u përfshirë dhe për të përfunduar çdo detyrë;

**Treguesi 5: Përdorimi i mjeteve (didaktike dhe digjitale)**

**Përshkruesi 1. Mësuesi përdor mjetet mësimore për aktivitetin ditor**

Mësuesi vlerësohet për:

- sigurimin e materialeve didaktike dhe të mjeteve të planifikuara për aktivitetin ditor;
- konkretizimin e mësimit me mjete mësimore dhe didaktike të përshtatshme për temën e mësimit;
- sigurimin e pajisjeve dhe të mjeteve digjitale dhe përdorimin e tyre gjatë zhvillimit të aktivitetit ditor;

**Përshkruesi 2. Mësuesi përdor mjete për të zhvilluar aftësitë e fëmijëve**

Mësuesi vlerësohet për:

- sigurimin e materialeve didaktike, të lodrave dhe mjeteve që zhvillojnë aftësitë gjuhësore, fizike, njohëse dhe social-emocionale të fëmijëve;
- sigurimin e mjeteve të duhura për secilën qendër veprimtarie dhe për aktivitetet që do të kryejnë fëmijët nëpër to.

## Kriteret e vlerësimit të aktivitetit të hapur ditor

Në Shtojcën 1 të Udhëzimit të MAS-it Nr.17, datë 22.07.2024 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë”. jepet formati i instrumentit për vlerësimin e orës mësimore të hapur, e cila, në arsimin parashkollor përkon me aktivitetin ditor.

Formati përmban Treguesit e cilësisë, Përshkruesit, Totalin e pikëve për secilin përshkrues, Nivelet e vlerësimit dhe Pikët e fituara nga mësuesi. Mësuesi duhet të fitojë 60% të pikëve të secilit komponent të aktivitetit ditor.

Kriteret e vlerësimit të aktivitetit ditor:

- mbështesin mësuesit që do të kualifikohen për të planifikuar dhe për të organizuar një aktivitet ditor cilësor, efektiv dhe rezultativ për arritjet e fëmijëve;
- i shërbejnë drejtuesit dhe anëtarëve të rrjetit profesional, drejtuesit të kopshtit, si dhe pjesëmarrësve të tjerë gjatë zhvillimit të aktivitetit të hapur ditor për të gjykuar dhe vlerësuar me objektivitet cilësinë dhe efektivitetin e tij.

Gjatë zhvillimit të aktivitetit ditor mësuesi vëzhgohet dhe vlerësohet për procedurën që ndjek, me qëllim shkëmbimin e përvojave pozitive dhe përmirësimin e veprimtarisë mësimore-edukative në të ardhmen. Mësuesi mendon në mënyrë kritike, bën pyetje, pret përgjigje e diskuton me pjesëmarrësit që e vëzhguan. Nga diskutimet, mësuesi nxjerr në dukje ndryshimet, përmirësimet dhe sukseset e arritura.

**Kriteret për vlerësimin e aktivitetit të hapur ditor për kategoritë “Mësues i kualifikuar” dhe “Mësues specialist”**

| Gjithsej 30 pikë | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Përshkruesit** | **Niveli 1 (Dobët)** | **Niveli 2 (Mjaftueshëm)** | **Niveli 3 (Mirë)** | **Niveli 4 (Shumë mirë)** |
| **Planifikimi i aktivitetit ditor (6 pikë)** | | | | |
| | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| **Mësuesi e ka planifikuar aktivitetin ditor sipas rubrikave të përcaktuara, në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të të nxënit (3 pikë)** | ▪ Planifikimi nuk ka elemente të mësimdhënies me fëmijën në qendër. Deri diku, planifikimi mbështetet në zhvillimin dhe të nxënit e fëmijëve të grup moshës me të cilën punon mësuesi.<br>▪ Planifikimi është bërë sipas rubrikave të përcaktuara, por nuk është i | ▪ Planifikimi ka pak elemente të mësimdhënies me fëmijën në qendër. Planifikimi mbështetet në zhvillimin dhe të nxënit e fëmijëve të grup moshës me të cilën punon mësuesi.<br>▪ Planifikimi respekton rubrikat e përcaktuara, por është pjesërisht i detajuar.<br>▪ Jo të gjitha aktivitetet e parashikuara në plan përmbushin arritjen e | ▪ Mësuesi ka planifikuar aktivitetin ditor duke u bazuar në mësimdhënien me fëmijën në qendër.<br>▪ Planifikimi është bërë sipas rubrikave të përcaktuara.<br>▪ Ka larmi aktivitetesh, të cilat përgjithësisht rrjedhin natyrshëm nga njëra etapë në tjetrën.<br>▪ Planifikimi i pjesës më të madhe të veprimtarive stimulon entuziazmin e | ▪ Mësuesi ka planifikuar aktivitetin ditor duke u bazuar në mësimdhënien me fëmijën në qendër. Planifikimi është bërë në mënyrë të tillë që çdo fëmijë i grupit të ketë sukses.<br>▪ Planifikimi është bërë sipas rubrikave, duke përmbushur kërkesat e plotësimit të tyre.<br>▪ Aktivitetet e parashikuara në plan përmbushin arritjen e rezultateve të të nxënit nga fëmijët e grupit. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | detajuar në kërkesat për plotësimin e tyre.<br>▪ Aktivitetet e parashikuar a nuk kanë lidhje me rezultatet e të nxënit.<br>▪ Është e paqartë renditja e aktiviteteve. | rezultateve të të nxënit nga fëmijët e grupit.<br>▪ Ka aktivitete, por jo për çdo etapë të aktivitetit ditor.<br>▪ Disa veprimtari mundet të stimulojnë interesat dhe dëshirat e fëmijëve. | fëmijëve, interesat, dëshirat dhe kuriozitetin e tyre moshor. | ▪ Ka balancë në llojet e aktiviteteve të përcaktuara në plan që do të kryhen me fëmijët në etapa të ndryshme të aktivitetit ditor. Organizimi i punës së fëmijëve është i qartë dhe veprimtaritë rrjedhin natyrshëm te njëra-tjetra.<br>▪ Planifikimi i të gjitha veprimtarive stimulon entuziazmin e fëmijëve, interesat, dëshirat dhe kuriozitetin e tyre moshor. |
| **Mësuesi ka planifikuar për aktivitetin ditor qasje** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | ▪ Mësuesi ka bërë një planifikim ditor rutinë, pa u | ▪ Planifikimi i mësuesit ka më shumë elementë të mësimdhënies | ▪ Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje të reja inovative. Situatat dhe | ▪ Mësuesi planifikon veprimtari për takimin e mëngjesit, |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës, krahas kompetencave lëndore (3 pikë)** | kujdesur për qasje të reja inovative dhe pa përfshirë edhe zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës. | tradicionale, pa përfshirë qasjet e reja inovative dhe përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie.<br>▪ Veprimtaritë e planifikuara nuk kanë në fokus kompetencat kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës, por vetëm kompetencat lëndore. | rastet konkrete lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin e TIK dhe me gjithëpërfshirjen.<br>▪ Në planifikim mësuesi ka mbajtur parasysh disa prej kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës. | nëpërmjet të cilave i qartëson fëmijët se çfarë do të bëjnë gjatë ditës.<br>▪ Planifikimi është i mbështetur në situata dhe raste konkrete dhe i sjellë nëpërmjet qasjeve inovative.<br>▪ Në planifikim mësuesi përzgjedh metoda dhe forma pune që i ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë njohuri, aftësi dhe shprehi për jetën.<br>▪ Planifikimi ruan raportet ndërmjet veprimtarive brenda e jashtë kopshtit, ndërmjet veprimtarive të qeta dhe aktive, ndërmjet |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | veprimtarive individuale, në grup të vogël dhe në grup të madh.<br>▪ Në plan janë planifikuar veprimtari të cilat u përshtaten diferencave që kanë fëmijët nga njëri-tjetrin. |
| **Mjedisi i të nxënit (6 pikë)** | | | | |
| **Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, dhe një mjedis ku fëmijët trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri-tjetrin (3 pikë)** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | ▪ Në klasë nuk ndihet të ketë një mjedis emocional pozitiv.<br>▪ Vëmendja e mësuesit është përqendruar te disa fëmijë, të cilët përfshihen, pyeten dhe aktivizohen më shumë | ▪ Mësuesi flet me një gjuhë të kuptueshme, por jo të gjithë fëmijët dëgjojnë me vëmendje.<br>▪ Mësuesi ka<br>▪ krijuar një mjedis emocional pozitiv, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim | ▪ Mësuesi flet me gjuhë të kuptueshme për të gjithë fëmijët.<br>▪ Ai ka krijuar një mjedis emocional pozitiv, të përshtatshëm për shëndetin dhe sigurinë e çdo fëmije.<br>▪ Në përgjithësi, mjedisi i nxit fëmijët të marrin pjesë, të ndër | ▪ Mësuesi flet me një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme për të gjithë fëmijët.<br>▪ Ai ka krijuar një mjedis emocional pozitiv, të përshtatshëm për shëndetin dhe sigurinë e çdo fëmije.<br>▪ Mjedisi i klasës është i organizuar në bazë të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | gjatë aktivitetit ditor.<br>▪ Fëmijët nuk shfaqin interes për veprimtaritë që zhvillohen dhe nuk shfaqin shenja të besimit te vetja.<br>▪ Mjedisi i klasës nuk u krijon fëmijëve të marrin pjesë, të ndër veprojnë, të luajnë dhe të mësojnë. | e vlerësim për veten.<br>▪ Fëmijët trajtohen në mënyrë të barabartë, por jo të gjithë i shprehin lirshëm mendimet. | veprojnë, të luajnë dhe të mësojnë.<br>▪ Mjedisi i brendshëm fizik nuk është plotësisht i ndërtuar në mënyrë të tillë që fëmijët të kenë mundësi të punojnë individualisht, në grup të vogël ose në grup të madh;<br>▪ Në klasë nuk janë të dukshme të gjitha qendrat, por ato që janë kanë lodra, materiale dhe mjete mësimore të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore - edukative dhe krijojnë te fëmijët klimë | këndeve/qendrave të veprimtarive.<br>▪ Mjedisi është ndërtuar në mënyrë të tillë që të gjithë fëmijët nxiten të marrin pjesë, të ndër veprojnë, të luajnë dhe të mësojnë.<br>▪ Mjedisi i brendshëm fizik është ndërtuar në mënyrë të tillë që fëmijët kanë mundësi të punojnë individualisht, në grup të vogël ose në grup të madh;<br>▪ Në mjedisin e jashtëm fizik fëmijëve u krijohet mundësia të qëndrojnë dhe të luajnë në ajër të pastër. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | pozitive bashkëpunimi. | ▪ Qendrat janë të pasura me lodra, materiale dhe mjete mësimore të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore - edukative dhe klimë pozitive bashkëpunimi.<br>▪ Fëmijët e grupit kanë vlerësim pozitiv për arritjet e tyre. |
| **Mësuesi krijon një mjedis të përshtatshëm për përfshirjen e fëmijëve në veprimtari, në bashkëpunime në nisma e ndërveprime të** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | ▪ Me mjedisin e krijuar fëmijët nuk zhvillojnë interesin dhe kuriozitetin e tyre moshor.<br>▪ Hapësirat fizike brenda klasës nuk u mundësojnë fëmijëve të | ▪ Me mjedisin e krijuar mësuesi mbështet deri diku interesin dhe kuriozitetin e fëmijëve.<br>▪ Mësuesi është përpjekur të krijojë hapësira fizike brenda klasës, por ato nuk u mundësojnë fëmijëve të lëvizin lirshëm. | ▪ Mësuesi mbështet entuziazmin e fëmijëve, habinë dhe kuriozitetin e tyre.<br>▪ Mësuesi është përpjekur të krijojë hapësira fizike brenda klasës që u mundësojnë fëmijëve të lëvizin lirshëm | ▪ Në çdo mjedis, fëmijët kanë mundësi të zhvillojnë një ose disa prej aftësive: zgjidhjen e problemeve, vëzhgimin, zbulimin, kërkimin, bashkëpunimin, komunikimin dhe |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **ndryshme (3 pikë)** | lëvizin lirshëm dhe të punojnë njëherazi individualisht, në grup të vogël ose në grup të madh.<br>▪ Mjedisi i jashtëm nuk është i përshtatshëm për fëmijët që të luajnë në ajër të pastër.<br>▪ Fëmijët rrallë e ndihmojnë njëri-tjetrin. | ▪ Mjedisi i brendshëm nuk u krijon mundësi fëmijëve të punojnë njëherazi individualisht, në grup të vogël ose në grup të madh.<br>▪ Mësuesi kujdeset që në mjedisin e jashtëm fëmijët të luajnë në ajër të pastër.<br>▪ Fëmijët ndihmojnë njëri-tjetrin kur u kërkohet nga mësuesi. | nga njëra qendër në tjetrën.<br>▪ Mjedisi i brendshëm është organizuar në mënyrë të tillë që fëmijët kanë mundësi të punojnë individualisht, në grup të vogël ose në grup të madh dhe të kryejnë pjesën më të madhe të veprimtarive.<br>▪ Mësuesi kujdeset që në mjedisin e jashtëm fëmijët të luajnë në ajër të pastër.<br>▪ Fëmijët ndihmojnë njëri-tjetrin kur u kërkohet. | marrëdhëniet sociale.<br>▪ Hapësirat fizike brenda klasës krijojnë mundësi që fëmijët të lëvizin lirshëm nga njëra qendër në tjetrën.<br>▪ Mjedisi i brendshëm është organizuar në mënyrë të tillë që fëmijët kanë mundësi të punojnë individualisht, në grup të vogël ose në grup të madh.<br>▪ Mjedisi fizik i brendshëm është i pasur me lodra, mjete, materiale, libra e pajisje didaktike, që mundësojnë zhvillimin e aktiviteteve të larmishme dhe ndërmarrjen e nismave të ndryshme. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | ▪ Mjedisi fizik i jashtëm u krijon mundësi fëmijëve që të qëndrojnë dhe të luajnë në ajër të pastër.<br>▪ Fëmijët ndihmojnë natyrshëm njëri-tjetrin sa herë e shohin të domosdoshme. |
| **Metodat e mësimdhënies (6 pikë)** | | | | |
| **Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues dhe diskutimin ndërmjet fëmijëve (3 pikë)** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | ▪ Çdo aktivitet i mësuesit është i udhëhequr prej tij.<br>▪ Disa lojëra dhe veprimtari praktike japin rezultate pozitive te fëmijët.<br>▪ Situatat që krijon | ▪ Mësuesi përdor metoda në përgjithësi tradicionale, ku çdo aktivitet është i udhëhequr prej tij.<br>▪ Disa lojëra dhe veprimtari praktike japin rezultate pozitive te fëmijët.<br>▪ Situatat që krijon mësuesi | ▪ Mësuesi përdor metoda ndërvepruese mësimdhënieje, lojëra dhe veprimtari praktike që japin rezultate pozitive te fëmijët.<br>▪ Ai krijon në përgjithësi situata që nxisin të menduarit dhe aftësitë | ▪ Mësuesi përdor metoda të larmishme të mësimdhënies me fëmijën në qendër, lojëra dhe veprimtari praktike që japin rezultate pozitive te fëmijët.<br>▪ Ai krijon situata që nxisin të menduarit dhe të arsyetuarit e fëmijëve, si dhe |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | mësuesi nuk nxisin të menduarin, arsyetimin dhe aftësitë krijuese të të gjithë fëmijëve, por vetëm të disa prej tyre.<br>▪ Gjatë aktivitetit ditor jo të gjithë fëmijët përfshihen në punë individuale, në punë në grupe të vogla dhe në punë në grup të madh. | nxisin pjesërisht të menduarit kritik të fëmijëve, por jo aftësitë e tyre krijuese.<br>▪ Aktiviteti ditor nuk është i qartë në raportin e punës individuale, punës në grupe të vogla dhe punës në grup të madh. | krijuese të fëmijëve.<br>▪ Aktiviteti ditor ka balanca të mira ndërmjet punës individuale, punës në grupe të vogla dhe punës me të gjithë klasën. | aftësitë krijuese dhe të zgjidhjes së situatave problemore.<br>▪ Mësuesi krijon balanca ndërmjet punës individuale, punës në grupe të vogla dhe punës me të gjithë klasën. |
| **Mësuesi drejton pyetje të llojeve të ndryshme dhe nxit fëmijët të** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | ▪ Mësuesi demonstron që nuk ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. | ▪ Në pjesën më të madhe të rasteve, pyetjet drejtohen nga mësuesi.<br>▪ Pyetjet janë në përgjithësi të | ▪ Mësuesi i thërret të gjithë fëmijët me emër.<br>▪ Mësuesi pyet dhe dëgjon fëmijët për të | ▪ Mësuesi i thërret të gjithë fëmijët me emër.<br>▪ Mësuesi pyet dhe dëgjon fëmijët për të kuptuar atë që |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **përgjigjen dhe të bëjnë edhe ata pyetje (3 pikë)** | ▪ Ai nuk përdor pyetje të llojeve dhe niveleve të ndryshme.<br>▪ Gjithashtu, pyetjet i drejton vetëm mësuesi dhe nuk nxit fëmijët të bëjnë pyetje. | nivelit bazë dhe mesatar. Mbizotërojnë pyetje të tipit: mësues-fëmijë<br>▪ Fëmijët zbatojnë me ndihmën e mësuesit rregullat e grupit dhe procedurat rutinë.<br>▪ Fëmijët zbatojnë rregullat e vendosura, si: marrjen e fjalës, dëgjimin e shokut etj., kur ua kujton mësuesi.<br>▪ Fëmijët nuk shprehin vlerësime pozitive për veten. | kuptuar atë që thonë dhe mendojnë ata.<br>▪ Pyetjet janë pothuajse të të gjitha niveleve dhe në përgjithësi të tipit: mësues-fëmijë, fëmijë-fëmijë dhe fëmijë-mësues.<br>▪ Fëmijët i zgjedhin vetë veprimtaritë nëpër qendrat e aktivitetit.<br>▪ Fëmijët zbatojnë rregullat e grupit dhe procedurat e përditshme rutinë.<br>▪ Fëmijët zbatojnë kur ua kujton mësuesi rregullat e vendosura, si: marrjen e fjalës, dëgjimin e shokut etj. | thonë dhe mendojnë ata.<br>▪ Pyetjet janë të niveleve të ndryshme dhe të tipit: mësues-fëmijë, fëmijë-fëmijë dhe fëmijë-mësues.<br>▪ Fëmijët janë të aftë të zgjedhin veprimtaritë nëpër qendrat e aktivitetit.<br>▪ Fëmijët njohin rregullat e grupit dhe procedurat rutinë të përditshme<br>▪ Fëmijët bashkëbisedojnë lirshëm me mësuesen dhe fëmijët e tjerë.<br>▪ Fëmijët zbatojnë rregullat e vendosura, si: marrjen e fjalës, dëgjimin e shokut etj.<br>▪ Fëmijët shfaqin vlerësime |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | ▪ Pjesa më e madhe e fëmijëve shfaqin vlerësime pozitive për veten. | pozitive për veten. |
| **Vlerësimi i fëmijëve (6 pikë)** | | | | |
| **Mësuesi vëzhgon për të identifikuar nevojat për përmirësim të fëmijëve të grupit dhe lehtëson procesin e tyre të të nxënit (3 pikë)** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | ▪ Mësuesi vëzhgon dhe monitoron shumë pak fëmijë gjatë aktivitetit ditor.<br>▪ Mësuesi përdor të njëjtat mënyra e strategji të dokumentimit, vëzhgimit dhe vlerësimit të arritjeve të çdo fëmije, por nuk ka plane për përmirësimin e tyre. | ▪ Mësuesi i vëzhgon fëmijët gjatë kohës që luajnë dhe kryejnë aktivitete të ndryshme.<br>▪ Mësuesi, i motivon fëmijët herë pas here për të zhvilluar aftësitë që kanë.<br>▪ Herë-herë, mësuesi nxit çdo fëmijë të ndihet i pranuar, i vlerësuar dhe i dashur nga të tjerët.<br>▪ Mësuesi përdor të njëjtat mënyra e | ▪ Mësuesi i vëzhgon në mënyrë të qëllimtë fëmijët gjatë kohës që luajnë dhe kryejnë aktivitete të ndryshme.<br>▪ Mësuesi, përgjithësisht, i motivon fëmijët për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë.<br>▪ Në përgjithësi, mësuesi nxit çdo fëmijë të ndihet i pranuar, i vlerësuar dhe i dashur nga të tjerët. | ▪ Mësuesi i vëzhgon në mënyrë sistematike dhe të qëllimtë fëmijët gjatë kohës që luajnë dhe kryejnë aktivitete të ndryshme.<br>▪ Mësuesi i motivon fëmijët për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë.<br>▪ Fëmijët japin mendime për atë çfarë kanë arritur<br>▪ Mësuesi bën të mundur që çdo fëmijë ndihet i pranuar, i vlerësuar dhe i |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | strategji të dokumentimit, vëzhgimit dhe vlerësimit të arritjeve të çdo fëmije.<br>▪ Mësuesi nuk përdor fjalë fyese ose diskriminuese ndaj fëmijëve. | ▪ Mësuesi përdor disa mënyra e strategji të dokumentimit, vëzhgimit dhe vlerësimit të arritjeve të çdo fëmije.<br>▪ Mësuesi nuk përdor fjalë fyese ose diskriminuese ndaj fëmijëve. | dashur nga të tjerët.<br>▪ Mësuesi krijon dhe përshtat teknika vlerësimi që i përgjigjen zhvillimit individual të fëmijës në përputhje me programet mësimore.<br>▪ Mësuesi përdor mënyra e strategji të ndryshme të dokumentimit, vëzhgimit dhe vlerësimit të arritjeve të çdo fëmije. Ai përdor gjeste ose simbole vlerësuese, në përshtatje me grup moshën e fëmijëve.<br>▪ Mësuesi nuk përdor fjalë fyese ose diskriminuese ndaj fëmijëve. |

| Mësuesi përfshin fëmijët në veprimtari të diferencuar a sipas nevojave të tyre (3 pikë) | 0 pikë | 1 pikë | 2 pikë | 3 pikë |
|---|---|---|---|---|
| | ▪ Mësuesi planifikon veprimtari për të gjithë fëmijët njësoj, pa marrë parasysh mundësitë, vështirësitë ose nevojat e tyre të veçanta. | ▪ Mësuesi planifikon veprimtari për të gjithë fëmijët dhe bën diferencimin e tyre nëse ka fëmijë që nuk i përmbushin dot.<br>▪ Në përgjithësi, mësuesi krijon situata dhe veprimtari që pjesa më e madhe e fëmijëve i kryen pa ndihmën e tij. | ▪ Mësuesi realizon veprimtari të veçanta për fëmijët që paraqesin vështirësi në të nxënë ose kanë nevoja të veçanta.<br>▪ Mësuesi krijon situata që i ndihmojnë fëmijët të bëjnë më të mirën e tyre. | ▪ Mësuesi nxit interesat e fëmijëve dhe përgëzon përpjekjet e tyre, duke shfaqur besim në aftësitë e tyre.<br>▪ Mësuesi krijon situata të qëllimshme dhe veprimtari të veçanta duke ndihmuar çdo fëmijë të përmbushë potencialin e tij.<br>▪ Shfaq respekt për të gjithë fëmijët, pa përjashtim, pa diskriminime negative ose pozitive. |
| **Përdorimi i mjeteve (didaktike dhe digjitale) (6 pikë)** | | | | |
| **Mësuesi përdor mjetet** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | ▪ Mësuesi nuk përdor | ▪ Mësuesi ka përgatitur/sigur | ▪ Mësuesi ka përgatitur/sigur | ▪ Mësuesi ka përgatitur/siguru |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **mësimore për aktivitetin ditor (3 pikë)** | materiale dhe mjete mësimore didaktike për<br>▪ realizimin e disa veprimtarive të aktivitetit ditor.<br>▪ Mësuesi nuk përdor teknologji gjatë aktivitetit ditor. | uar materiale dhe mjete që i duhen për realizimin e disa veprimtarive të aktivitetit ditor, por ato nuk përbëjnë risi inovative në mësimdhënien e arsimit parashkollor.<br>▪ Mësuesi nuk përdor teknologji gjatë aktivitetit ditor. | uar materiale dhe mjete që i duhen për realizimin e disa veprimtarive të aktivitetit ditor, disa prej të cilave përbëjnë risi inovative në mësimdhënien e arsimit parashkollor.<br>▪ Mësuesi përpiqet të përdorë njërin prej programeve më të njohura kompjuterike. | ar të gjitha materialet dhe mjetet që i duhen për realizimin e aktivitetit ditor, të cilat përbëjnë risi inovative në mësimdhënien e arsimit parashkollor.<br>▪ Ai prezanton materiale didaktike duke përdorur programet më të njohura kompjuterike. |
| **Mësuesi përdor mjete për të zhvilluar aftësitë e fëmijëve (3 pikë)** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | ▪ Mësuesi nuk përdor mjete që i zhvillojnë aftësitë e fëmijëve gjatë veprimtarive të aktivitetit ditor. | ▪ Mësuesi përdor mjete një pjesë e të cilave zhvillon disa prej aftësive të fëmijëve në drejtim të zhvillimit gjuhësor, njohës, fizik dhe social-emocional. | ▪ Mësuesi përdor mjete në momente të caktuara të aktivitetit ditor.<br>▪ Ai i ndihmon fëmijët të zhvillojnë aftësitë e tyre nëpërmjet përdorimit të mjeteve të | ▪ Mësuesi përdor mjete që zhvillojnë aftësitë e fëmijëve në gjetjen e rrugëve të përshtatshme që lehtësojnë zotërimin e koncepteve lëndore, që u mundësojnë të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | ▪ Mësuesi nuk përdor asnjë mjet apo burim digjital. | ▪ Mësuesi përdor me vështirësi mjete teknologjike në një moment të aktivitetit ditor. | duhura në qendrat e veprimtarive.<br>▪ Mësuesi përdor mjete teknologjike dhe i nxit fëmijët të kryejnë punime të thjeshta në kompjuter, të shohin përralla, të zhvillojnë lojëra didaktike apo të dëgjojnë këngë për fëmijë. | shprehen në mënyra të ndryshme, që krijojnë marrëdhënie e bashkëpunime me shokët, që zhvillojnë motorikën e madhe dhe fine.<br>▪ Ai i ndihmon fëmijët të nisin të mësojnë burimet bazë të teknologjisë, si kompjuterin, programe didaktike, internetin etj.<br>▪ Mësuesi drejton dhe mbikëqyr fëmijët në përdorimin e teknologjisë, për t'i mbështetur në të mësuarit e tyre. |

## Orientime dhe udhëzime për projektin kurrikular–Kategoritë "Mësues specialist" dhe "Mësues mjeshtër"

Projekti kurrikular nxit fëmijët të marrin iniciativa për të vepruar, menduar dhe për të realizuar. Të gjitha projektet në arsimin parashkollor burojnë nga interesat e fëmijëve, nga shqetësimet apo pyetjet që u lindin në mendje. Zhvillimi i projekteve të iniciuara nga fëmijët parashkollorë

është një mënyrë e fuqishme për të nxitur një mjedis mësimor të pasur dhe stimulues. Kjo qasje jo vetëm që ndihmon në zhvillimin e aftësive të ndryshme, por gjithashtu i bën fëmijët të ndihen të lidhur me procesin e të mësuarit dhe të motivuar për të eksploruar botën rreth tyre. Mësuesit nxisin projekte që zgjerojnë dhe sfidojnë të nxënit e fëmijëve. Të nxënit zhvillohet natyrshëm dhe udhëhiqet nga kurioziteti dhe pyetjet e fëmijëve. Pavarësisht programit edukativ që zbatohet në kopsht, mësuesit mund të planifikojnë dhe të realizojnë së bashku me fëmijët projekte kurrikulare, të cilat mund të jenë me kohëzgjatje të ndryshme.

## Struktura dhe përmbajtja e rubrikave të projektit kurrikular

| | |
|---|---|
| **Tema e projektit** | Shkruhet tema e projektit që do të punohet me fëmijët. Tema e projektit është e afërt me interesat dhe përvojat e fëmijëve dhe bën të mundur që çdo fëmijë të jetë i angazhuar plotësisht në realizimin e tij. |
| **Hyrje – Si lindi projekti** | Përshkruhet si lindi ideja e realizimit të këtij projekti, nisur nga diskutimet e hapura me fëmijët për tema e çështje të ndryshme.<br>Përshkruhen bisedat e mësueses me fëmijët e grupit, pyetjet që u ka drejtuar për të mbledhur mendimet e tyre, për të ngjallur interesin dhe kuriozitetin, si dhe për të kuptuar fushën e tyre të interesit.<br>Përshkruhen idetë që kanë hedhur fëmijët, hipotezat që kanë ngritur, mendimet e tyre të para, bisedat mes fëmijëve dhe elemente të tjera që mësuesja ka vëzhguar dhe mbajtur shënim.<br>Gjithashtu, përshkruhet dakordësia me fëmijët për të zgjedhur temën dhe për të punuar së bashku për këtë projekt. |
| **Qëllimet e projektit** | Mësuesi luan një rol aktiv në prezantimin e projektit dhe sigurimin e udhëzimeve të qarta për qëllimet e tij. Ai shpjegon konceptet kryesore dhe përfshin fëmijët në diskutime për t'u siguruar që ata e kuptojnë temën dhe synimet e projektit. Projekti synon zhvillimin e fëmijëve sipas secilës fushë:<br>• **Zhvillimi njohës:** Zhvillimi i aftësive themelore të të menduarit, të kuptuarit dhe të zgjidhjes së problemeve.<br>• **Zhvillimi social-emocional:** Nxitja e aftësive për të bashkëvepruar me të tjerët, ndërtimi i vetëbesimit dhe zhvillimi i vetëkontrollit emocional.<br>• **Zhvillimi motorik:** Përmirësimi i aftësive fizike përmes lojërave dhe aktiviteteve që ndihmojnë në përvetësimin e koordinimit të lëvizjeve.<br>• **Zhvillimi i gjuhës dhe komunikimit:** Fëmijët ndihmohen për të kuptuar dhe për të shprehur veten në të gjitha "gjuhët" e tyre. |
| **Plani i projektit** | Projekti është i lidhur sa me përgatitjen e mësuesit, aq edhe me veprimtaritë konkrete të fëmijëve. Në draftimin e projektit mësuesi duhet të mbajë parasysh:<br>• **Rezultatet e të nxënit**: Çfarë dëshiron/pret të arrijnë fëmijët nga projekti; Cilat janë aftësitë dhe njohuritë që duhet të |

| | |
|---|---|
| | ndërtojnë/zhvillojnë fëmijët gjatë këtij projekti.<br>• **Veprimtaritë**: Ideimi i aktiviteteve kryesore që lidhen me temën, të cilat burojnë nga mendimet që kanë shfaqur fëmijët dhe që pasurohen nga dita në ditë.<br>• **Krijimin e hapësirave të veçanta për aktivitete të ndryshme** në të cilat fëmijët do të bëjnë kërkime, hulumtime, do të luajnë, do të eksperimentojnë dhe do të punojnë në mënyrë individuale ose në grupe.<br>• **Fleksibilitetin e hapësirave**. Qendrat dhe hapësirat duhet të jenë fleksibile për t'u përshtatur me nevojat dhe interesat e fëmijëve. Mësuesi duhet të jetë i gatshëm të bëjë ndryshime në organizimin e hapësirave dhe të aktiviteteve në përputhje me reagimet e fëmijëve.<br>• **Burimet:** Identifikimi i materialeve, i mjeteve dhe i burimeve që do të përdoren gjatë zhvillimit të veprimtarive në faza të ndryshme të projektit.<br>• **Konceptet dhe njohuritë nga programet mësimore:** Njohuritë, aftësitë, vlerat dhe qëndrimet që zhvillon projekti në përputhje me kurrikulën e arsimit parashkollor. |
| **Zbatimi i projektit** | Mësuesi e ndan projektin në hapa të vegjël dhe të kuptueshëm për fëmijët, duke dhënë udhëzime të thjeshta dhe konkrete për çdo fazë të tij. Në realizimin e projektit mësuesi kujdeset për:<br>• **Krijimin e një kalendari aktivitetesh**. Mësuesi ndihmon fëmijët të planifikojnë një kalendar me aktivitete të caktuara dhe afate kohore, duke i mësuar njëherazi si të menaxhojnë kohën e tyre dhe t'i japin rëndësi aktiviteteve.<br>• **Aktivitetet e përditshme.** Zbatimi i aktiviteteve në përputhje me planin e projektit, duke përfshirë lojëra didaktike, aktivitete me lëvizje, krijimtari artistike dhe diskutime të hapura për të nxitur shprehjen e ideve dhe të emocioneve; përshtatja e aktiviteteve sipas interesave dhe zhvillimeve gjatë projektit.<br>• **Përdorimin e formave të ndryshme të lojës** dhe krijimin e situatave të ndryshme për të zgjidhur probleme. |

| | |
|---|---|
| | • **Vëzhgimin e 'pavarësisë' së fëmijëve**. Gjatë realizimit të projektit, mësuesi mbikëqyr dhe vëzhgon aktivitetet e fëmijëve. Vëzhgimi i siguron informacion që fëmijët janë të angazhuar dhe ndjekin hapat e projektit, ndërkohë që mësuesi inkurajon pavarësinë dhe krijimtarinë e tyre.<br>• **Monitorimin e progresit të fëmijëve**. Mësuesi ndjek progresin e secilit fëmijë, duke vëzhguar se si ata punojnë dhe ndër veprojnë me materialet dhe me njëri-tjetrin. Kjo e ndihmon të kuptojë nevojat individuale dhe të bëjë rregullime kur është e nevojshme.<br>• **Mbështetjen e zhvillimit individual të fëmijëve.** Mësuesi përqendrohet në nevojat e secilit fëmijë dhe u jep atyre mundësi për të eksploruar sipas ritmit individual. |
| **Fazat e projektit** | Projekti kalon në disa faza.<br>1. **Faza e planifikimit.** Mësuesi ndihmon fëmijët të formulojnë idetë e tyre dhe t'i japin një strukturë projektit. Ai mund të ofrojë sugjerime të thjeshta dhe të inkurajojë fëmijët të marrin vendime të vogla që janë të arritshme dhe kuptimplote për ta.<br>2. **Faza e zhvillimit.** Gjatë zhvillimit të projektit, mësuesi ofron udhëzime të qarta, mbështet përdorimin e materialeve dhe ndihmon fëmijët të ndjekin një rrjedhë logjike në punën e tyre. Ai inkurajon fëmijët të eksplorojnë dhe të zgjidhin problemet në mënyrë të pavarur, ndërkohë që është i gatshëm për t'iu përgjigjur pyetjeve.<br>3. **Faza e përfundimit dhe prezantimit.** Mësuesi ndihmon fëmijët të organizojnë rezultatet dhe produktet e projektit të tyre. Ai u ofron udhëzime për mënyrën e prezantimit të punës së tyre përpara grupit, duke i ndihmuar të demonstrojnë atë që kanë mësuar dhe të interpretojnë punët dhe veprimtaritë e kryera.<br>4. **Faza e reflektimit.** Në përfundim të projektit, mësuesi nxit fëmijët të reflektojnë mbi përvojën e fituar, duke i pyetur për atë që kanë mësuar dhe çfarë do të bëjnë ndryshe në projektin e radhës. Kjo rrit aftësinë e fëmijëve për të menduar në mënyrë kritike dhe për të përvetësuar njohuritë e reja. |
| **Kohëzgjatja** | Projekti mund të zhvillohet brenda një muaji, brenda një periudhe ose mund |

| | |
|---|---|
| **e projektit** | të jetë i shtrirë përgjatë gjithë vitit. Kohëzgjatja e projektit është e lidhur me dinamikat dhe interesin e fëmijëve në veprimtaritë që zhvillohen në kuadër të tij. |
| **Produkti final** | Përgatitja e produktit final të një projekti nga fëmijët parashkollorë është një hap i rëndësishëm që përfshin bashkëpunimin mes mësuesit dhe fëmijëve.<br><br>*a) Disa aspekte që duhet të mbahen parasysh nga mësuesi:*<br><br>▪ **Qëllimet e projektit.** Mësuesi duhet të sigurojë që produkti final të përputhet me qëllimet dhe rezultatet e projektit. Kjo do të ndihmojë fëmijët të kuptojnë rëndësinë e punës së tyre.<br>▪ **Angazhimi i fëmijëve.** Mësuesi duhet të inkurajojë pjesëmarrjen aktive të fëmijëve në përgatitjen e produktit final, duke i lejuar ata të kontribuojnë me idetë e tyre dhe të marrin vendime në lidhje me procesin krijues.<br>▪ **Materialet dhe mjetet.** Sigurimi i materialeve dhe mjeteve të nevojshme për të realizuar produktin final. Mësuesi duhet të jetë i vetëdijshëm për nevojat dhe mundësitë e fëmijëve në zgjedhjen e materialeve.<br>▪ **Planifikimi i aktiviteteve.** Mësuesi duhet t'i udhëheqë fëmijët në kryerjen e aktiviteteve që janë të përshtatshme për nivelin e zhvillimit të fëmijëve, që nxisin kreativitetin dhe mendimin kritik. Mësuesi i nxit fëmijët të shprehin aftësitë e tyre krijuese duke i lejuar të eksperimentojnë me forma, ngjyra dhe teknika të ndryshme gjatë procesit të krijimit të produktit.<br>▪ **Sigurimi i mbështetjes.** Mësuesi duhet të ofrojë udhëzime dhe mbështetje gjatë procesit të përgatitjes, duke i ndihmuar fëmijët të përballen me sfidat dhe të zhvillojnë aftësi të reja.<br>▪ **Pjesëmarrja e prindërve.** Mësuesi duhet të inkurajojë përfshirjen e prindërve në procesin e zhvillimit të projektit në faza të ndryshme të tij, duke ndihmuar me materialet ose duke ofruar ide dhe burime.<br>▪ **Vlerësimi dhe reflektimi.** Mësuesi planifikon një mënyrë për të vlerësuar produktin final. Ai i nxit fëmijët të reflektojnë mbi gjithë |

| | |
|---|---|
| | ecurinë e projektit, duke i pyetur për sfidat dhe sukseset që kanë hasur gjatë punës së tyre.<br><br>b) *Disa aspekte që duhet të mbajnë parasysh fëmijët:*<br><br>▪ **Krijimi i ideve.** Fëmijët duhet të inkurajohen të shprehin idetë e tyre dhe të kontribuojnë në zhvillimin e produktit final. Kjo i ndihmon të ndihen të përfshirë dhe të vlerësuar.<br>▪ **Pjesëmarrja aktive.** Fëmijët duhet të përfshihen në aktivitetet, të tregojnë përkushtim dhe të bashkëpunojnë me shokët e tyre.<br>▪ **Përdorimi i materialeve.** Fëmijët duhet të eksplorojnë dhe të përdorin materiale të ndryshme për të realizuar produktin e tyre, duke u njohur me teknika të reja dhe mënyra të ndryshme krijuese.<br>▪ **Komunikimi dhe bashkëpunimi.** Fëmijët duhet të praktikojnë komunikimin dhe bashkëpunimin me shokët e tyre. Kjo është e rëndësishme për të ndarë ide dhe për të punuar si një ekip.<br>▪ **Reflektimi mbi procesin.** Fëmijët duhet të reflektojnë mbi atë që kanë mësuar gjatë procesit dhe si kanë kontribuar në produktin final. Kjo i ndihmon ata të kuptojnë vlerën e punës së tyre dhe përmirësimin që mund të bëjnë në të ardhmen.<br>▪ **Kënaqësia dhe gëzimi.** Fëmijët duhet të fokusohen në kënaqësinë dhe gëzimin që sjell përgatitja e produktit final. Një qëndrim pozitiv ndihmon në rritjen e motivimit dhe të angazhimit në projekte të reja.<br>▪ **Prezantimi i produktit.** Fëmijët duhet të përgatiten për të prezantuar produktin e tyre përpara të tjerëve. Kjo mund të jetë një mundësi për të zhvilluar aftësinë e komunikimit dhe të ndihen të rëndësishëm në atë që kanë krijuar. |
| **Dokumentimi i projektit** | Dokumentimi i punës dhe i komenteve të fëmijëve parashkollorë gjatë zbatimit të një projekti është një praktikë e rëndësishme që ndihmon në monitorimin e procesit mësimor, vlerësimin e përparimit të fëmijëve dhe përmirësimin e praktikave edukative.<br><br>**Regjistrimi i aktiviteteve** |

| | |
|---|---|
| | • **Shënimet ditore.** Krijimi i një ditari të aktiviteteve që dokumenton çdo hap të projektit. Ky dokument mund të përfshijë informacion mbi aktivitetet e realizuara, materialet e përdorura dhe përfshirjen e fëmijëve.<br>• **Fotografi dhe video**. Përdorimi i fotografive dhe i videove për të dokumentuar procesin e punës. Kjo ndihmon për të kapur momentet e rëndësishme dhe për të ilustruar përfshirjen e fëmijëve në aktivitete.<br><br>**Vlerësimi dhe reflektimi**<br>• **Fletët e reflektimit.** Pas përfundimit të aktiviteteve, fëmijët mund të mbushin fletë reflektimi ku shprehin mendimet e tyre mbi atë që kanë mësuar, çfarë u ka pëlqyer dhe çfarë do të donin të bënin ndryshe.<br>• **Diskutime në grup.** Organizimi i diskutimeve në grup pas zhvillimit të aktiviteteve për të inkurajuar fëmijët të ndajnë mendimet e tyre. Regjistrimi i këtyre diskutimeve mund të ofrojë informacion të vlefshëm mbi përvojat e fëmijëve.<br>**Komentet e fëmijëve**<br>• **Regjistrimi i komenteve**. Komentet dhe reagimet e fëmijëve gjatë aktiviteteve mbahen shënim. Këtu përfshihen komente pozitive, sugjerime ose pyetje që kanë bërë fëmijët.<br>• **Përdorimi i formateve të ndryshme**. Fëmijët mund të shkruajnë ose të vizatojnë mendimet e tyre rreth aktiviteteve. Kjo është veçanërisht e dobishme për ata fëmijë që nuk dinë të shkruajnë ende.<br><br>**Krijimi i një portofoli**<br>• **Portofoli i fëmijëve**. Për secilin fëmijë krijohet portofoli, në të cilin përfshihen punët e përfunduara, punimet e preferuara, komente dhe reflektime personale. Portofoli është një burim i vlefshëm për të ndjekur zhvillimin e secilit fëmijë dhe për të ndarë arritjet me prindërit.<br>• **Materiale të mbledhura**. Mësuesi ruan materialet e ndryshme që janë prodhuar gjatë projektit, si p.sh. vizatime, punë artizanale, ose krijime të tjera të fëmijëve. |

| | |
|---|---|
| | **Raportimi dhe komunikimi**<br>• **Raportet për prindërit**. Për prindërit përgatiten raporte që përfshijnë përfundimet e projektit, si dhe komente e reflektime të fëmijëve. Kjo ndihmon në përfshirjen e prindërve në procesin e mësimdhënies.<br>• **Prezantime**. Mësuesi organizon një ngjarje (event) ku fëmijët mund të prezantojnë punën e tyre për prindërit dhe anëtarët e tjerë të komunitetit. Kjo jo vetëm që dokumenton arritjet e fëmijëve, por gjithashtu ndihmon në zhvillimin e aftësive të komunikimit dhe prezantimit.<br><br>**Rishikimi dhe përmirësimi**<br>• **Analiza e dokumentacionit**. Pas përfundimit të projektit, analizohet dokumentacioni i mbledhur për të identifikuar arritjet dhe sfidat e fëmijëve. Kjo ndihmon mësuesit të kuptojnë se çfarë ka funksionuar mirë dhe çfarë mund të përmirësohet në projektet e ardhshme.<br>• **Planifikimi i projekteve të ardhshme.** Rezultatet e dokumentuara shërbejnë për planifikimin e aktiviteteve të reja dhe për të adresuar nevojat specifike të fëmijëve. |
| **Shënimet e mësuesit** | Gjatë aktiviteteve të përditshme, mësuesi mban shënime rreth vëzhgimeve që kryen. Ai dokumenton situata kur fëmija shfaq aftësi të forta kërkimore, si dhe raste kur fëmijët përpiqen të zgjidhin probleme në mënyrë kreative. Fëmijët shpesh shprehin atë që kanë mësuar përmes vizatimeve, tregimeve të thjeshta ose objekteve që ndërtojnë me materiale të ndryshme. Këto krijime tregojnë nivelin e tyre të të kuptuarit, përfshirjen në eksplorime/hulumtime dhe aftësinë për të përpunuar informacionin.<br>Gjatë prezantimeve, mësuesit mund të mbajnë shënime për mënyrën se si fëmijët i prezantojnë rezultatet e tyre. Për shembull, mësuesit mund të dokumentojnë nëse fëmijët përdorin gjuhën e përshtatshme, nëse janë të qartë në shpjegimet e tyre, dhe si reagojnë ndaj pyetjeve nga të tjerët. Pas prezantimeve, mësuesit mund të reflektojnë mbi vëzhgimet e tyre dhe të japin udhëzime për zhvillime të ardhshme. |
| **Portofoli i fëmijëve** | Mësuesi mban një portofol për secilin fëmijë në të cilin përfshin punime që tregojnë aftësitë e tyre për të analizuar dhe interpretuar, si vizatime, ndërtime me blloqe ose tregime që ata krijojnë gjatë zhvillimit të projektit. |

| | |
|---|---|
| | Këto punime mund të shfaqin se si fëmijët kanë përpunuar informacionin dhe kanë bërë analiza mbi atë që kanë mësuar.<br>Portofoli tregon progresin e tyre dhe do të jetë një burim për të vlerësuar zhvillimin e tyre kërkimor gjatë kohës. |
| **Përfundimi dhe prezantimi i projektit** | Përgatitja e produktit final të një projekti është mundësi shumë e mirë për të forcuar lidhjen mes mësuesit dhe fëmijëve, duke inkurajuar kreativitetin dhe angazhimin e tyre. Duke mbajtur parasysh këto aspekte, mësuesi dhe fëmijët punojnë së bashku për të krijuar një përvojë mësimore të pasur dhe të kënaqshme. Për të realizuar prezantime cilësore, fëmijët parashkollorë zhvillojnë disa aftësi që ndihmojnë në rritjen e besimit dhe efikasitetit të tyre gjatë komunikimit.<br><br>**Aftësitë e komunikimit**<br>• **Fjalori i pasur**. Ndihmesa e fëmijëve për të pasuruar fjalorin me fjalë dhe shprehje të reja.<br>• **Aftësitë e dëgjimit**. Mësuesit mund të ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë aftësitë e dëgjimit për të kuptuar më mirë pyetjet dhe reagimet e ‘publikut’.<br><br>**Shprehja verbale dhe jo-verbale**<br>• **Toni i zërit**. Mësimi për përdorimin e tonit të duhur të zërit për të shprehur emocionet dhe për të mbajtur vëmendjen e audiencës.<br>• **Gjuha e trupit**. Fëmijët ndihmohen të përdorin gjuhën e trupit dhe mimikën për të përcjellë mesazhe.<br><br>**Strukturimi i informacionit**<br>• **Organizimi i mendimeve**. Mësuesit i ndihmojnë fëmijët të organizojnë idetë e tyre në mënyrë logjike, duke filluar nga një hyrje, përshkrimi i detajeve dhe përfundimi.<br>• **Përdorimi i ndihmës vizuale**. Inkurajimi i fëmijëve të përdorin materiale vizuale si figura, piktura ose grafikë për të mbështetur informacionin që paraqesin. |

| | |
|---|---|
| | **Besimi në vetvete**<br>• **Inkurajimi i fëmijëve**. Fëmijët ndihmohen të ndihen të sigurt dhe të besojnë në aftësitë e tyre, duke i lavdëruar dhe mbështetur gjatë praktikave të prezantimeve.<br>• **Simulimi i situatave**. Krijimi i mundësive për fëmijët të praktikojnë prezantimet në një mjedis të sigurt dhe mbështetës, si në klasë ose para prindërve.<br><br>**Aftësitë e bashkëpunimit**<br>**Puna në grup**. Inkurajimi i fëmijëve të punojnë së bashku në prezantime për të zhvilluar aftësitë e komunikimit dhe bashkëpunimit.<br><br>**Përgatitja e aktiviteteve të grupit**. Krijimi i mundësive për të ndihmuar njëri-tjetrit gjatë përgatitjes së prezantimeve.<br><br>**Menaxhimi i stresit dhe emocioneve**<br>• **Teknikat e qetësisë**. Mësimi i teknikave të thjeshta për të menaxhuar stresin dhe emocionet, si frymëmarrja e thellë, përpara se të flasin përpara audiencës.<br>• **Përballja me frikën.** Fëmijët ndihmohen të përballen me frikën e fjalimit në publik duke u praktikuar shpesh dhe duke u inkurajuar të flasin para grupeve të vogla.<br><br>**Vlerësimi dhe reflektimi**<br>• **Vlerësimi i performancës**. Pas përfundimit të prezantimeve, fëmijët mund të reflektojnë mbi atë që kanë bërë dhe si është pritur projekti i tyre. Kjo ndihmon në rritjen e vetëbesimit dhe zhvillimin e vetëvlerësimit të tyre.<br>• **Feedback nga shokët dhe mësuesi**. Krijimi i mundësive për të marrë feedback konstruktiv nga të tjerët për të përmirësuar aftësitë e prezantimit. |

| | |
|---|---|
| **Partneriteti mësues-prind** | Prindërit luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e fëmijëve dhe kontribuojnë në zhvillimin e tyre të përgjithshëm. Në zbatimin e projekteve duhet:<br><br>**Komunikim i rregullt**<br>• **Informimi për projektin**: Mësuesit duhet të komunikojnë qartë me prindërit mbi projektin, qëllimet e tij dhe mënyrat se si ata mund të kontribuojnë. Kjo mund të bëhet përmes takimeve, letrave, ose komunikimeve në grupe të dedikuara online.<br>• **Rrjetet sociale dhe aplikacionet**: Përdorimi i platformave të komunikimit online për të ndarë informacion rreth aktiviteteve, rezultateve dhe ecurisë së projektit.<br><br>**Pjesëmarrje aktive**<br>• **Kontributi në aktivitete**: Prindërit mund të angazhohen në aktivitete të ndryshme ose në ofrimin e njohurive dhe përvojave të tyre për temën e projektit.<br>• **Vullnetarizmi**: Prindërit mund të ofrojnë ndihmë si vullnetarë në klasë, duke mbështetur mësuesin dhe fëmijët në zbatimin e aktiviteteve të projektit.<br><br>**Pjesëmarrje në aktivitete jashtë klasës**<br>• **Ekskursione dhe vizita**: Prindërit mund të ndihmojnë në organizimin e ekskursioneve ose të vizitave që lidhen me temën e projektit. Kjo u jep fëmijëve mundësinë të eksplorojnë më shumë dhe të përfshihen në mjedisin e tyre.<br>• **Ngjarje dhe aktivitete në komunitet**: Pjesëmarrja e prindërve në aktivitete të organizuara në komunitet mund të forcojë lidhjen midis kopshtit dhe familjes.<br><br>**Kontribut me burime** |

| | |
|---|---|
| | • **Materiale dhe mjete**: Prindërit mund të ofrojnë materiale të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve, si p.sh. libra, mjete artizanale ose ndihmë për të siguruar burime të tjera që lidhen me temën e projektit.<br>• **Ekspertë nga familja**: Nëse ndonjë nga prindërit ka ekspertizë në një fushë të caktuar, ata mund të ndihmojnë duke ofruar informacion dhe përvoja praktike për fëmijët.<br><br>**Diskutime në shtëpi**<br>• **Ndarja e informacionit**: Prindërit mund të inkurajohen të flasin me fëmijët e tyre për projektin, duke ndihmuar në forcimin e lidhjes mes shkollës dhe shtëpisë. Kjo ndihmon në përforcimin e njohurive që fëmijët marrin në klasë.<br>• **Aktivitetet në shtëpi**: Prindërit mund të krijojnë mundësi për aktivitete të ngjashme me ato që bëhen në klasë, duke inkurajuar fëmijët të eksperimentojnë dhe të mësojnë më shumë në mjedisin familjar.<br><br>**Vlerësim dhe reflektim**<br>• **Feedback dhe sugjerime**: Prindërit mund të ofrojnë feedback mbi përvojat e fëmijëve në projekt dhe të sugjerojnë mënyra për përmirësimin e aktiviteteve në të ardhmen.<br>• **Vlerësimi i rezultateve**: Prindërit mund të diskutojnë me fëmijët për atë që kanë mësuar dhe si mund t'i zbatojnë njohuritë e reja në jetën e tyre të përditshme.<br><br>**Krijim i një atmosfere mbështetjeje**<br>• **Inkurajimi i pjesëmarrjes**: Prindërit duhet t'i inkurajojnë fëmijët të angazhohen aktivisht në projekt dhe të shprehin mendimet e tyre. Një atmosferë mbështetjeje ndihmon në ndërtimin e vetëbesimit te fëmijët.<br>• **Krijimi i një marrëdhënieje të fortë**: Prindërit që angazhohen në projekte ndihmojnë në ndërtimin e një marrëdhënieje më të fortë me fëmijët e tyre, duke u dhënë atyre mundësinë të shprehin veten dhe të ndihen të vlerësuar. |

| | |
|---|---|
| **Arritja e rezultateve të të nxënit dhe reflektimi mbi përvojën e fituar** | Vlerësimi i interesit, kënaqësisë dhe përkushtimit të fëmijëve parashkollorë gjatë zhvillimit të projekteve është një proces i shumanshëm që kërkon përdorimin e disa metodave dhe teknikave. Këto vlerësime ndihmojnë mësuesit të kuptojnë nevojat dhe interesat e fëmijëve, duke ndihmuar kështu në krijimin e një mjedisi të nxëni më stimulues dhe përmbushës.<br>• **Prezantimi i rezultateve**: Mësuesi dhe fëmijët organizojnë një aktivitet në të cilin fëmijët prezantojnë rezultatet e projektit. Fëmijët tregojnë si ndihen teksa paraqesin punën e tyre, duke dhënë njëkohësisht informacion mbi interesin dhe përkushtimin e tyre ndaj temës.<br>• **Rrëfimet dhe përjetimet**: Fëmijët ndajnë përjetimet e tyre në lidhje me projektin dhe çfarë kanë mësuar përgjatë zbatimit të tij.<br>• **Vlerësimi i rezultateve**: Mësuesi ndihmon fëmijët të vlerësojnë arritjet e tyre, duke diskutuar se çfarë kanë mësuar dhe si kanë kontribuar në grup. Kjo ndihmon në ndërtimin e vetëbesimit dhe vetëvlerësimit.<br>• **Prezantimi i produkteve**: Mësuesi organizon një prezantim ku fëmijët mund të tregojnë punën e tyre dhe të flasin për atë që kanë mësuar, duke ndihmuar në zhvillimin e aftësive të komunikimit dhe të prezantimit.<br>• **Reflektimi mbi procesin e të nxënit**: Mësuesi nxit fëmijët të reflektojnë mbi përvojat e tyre dhe të diskutojnë se si mund t'a zbatojnë atë që kanë mësuar në aktivitete të tjera në të ardhmen. |

## Vlerësimi i projektit kurrikular

### A. Treguesi i cilësisë: Demonstrimi nga fëmijët i aftësive hulumtuese, kërkimore, krijuese

Vlerësimi i aftësive kërkimore/hulumtuese tek fëmijët parashkollorë gjatë zhvillimit të një projekti kërkon një qasje të ndjeshme dhe të përshtatur me moshën dhe zhvillimin e tyre. Aftësitë kërkimore te fëmijët e vegjël shfaqen përmes kureshtjes natyrore, eksplorimit të mjedisit, përvojave praktike dhe përpjekjeve për të zgjidhur probleme të thjeshta. Gjatë zhvillimit të projekteve, këto aftësi mund të vëzhgohen dhe të vlerësohen në mënyrë sistematike për të siguruar që fëmijët po përfitojnë nga përvojat mësimore-edukative.

#### a) Sjellja e fëmijëve gjatë lojës së lirë dhe të strukturuar

Shikoni se si fëmijët ndër veprojnë me materialet që u jepen (p.sh., lodra, objekte natyrore, libra, etj.). Vëzhgoni nëse ata përpiqen të eksplorojnë mënyra të ndryshme për të përdorur materialet, apo nëse bëjnë pyetje mbi to. Nëse fëmijët përdorin metoda të eksperimentimit ose bëjnë përpjekje për të zgjidhur probleme duke u përpjekur vazhdimisht, ata demonstrojnë aftësitë e tyre kërkimore.

#### b) Pyetjet dhe interesi i fëmijëve

Fëmijët parashkollorë shpesh shprehin kureshtjen e tyre duke bërë pyetje të thjeshta, si: "Pse?", "Si ndodh kjo?", "Çfarë është kjo?". Këto pyetje janë një shenjë e zhvillimit të aftësive kërkimore, pasi tregojnë interes për të mësuar më shumë rreth botës që i rrethon. Vëzhgoni nëse ata ndjekin përgjigjet tuaja me pyetje të tjera, çka tregon një përpjekje për të kuptuar më thellë një çështje.

#### c) Zgjidhja e problemeve dhe vendimet që marrin

Kur fëmijët hasin sfida gjatë lojës apo aktiviteteve (p.sh., ndërtimi me blloqe, gjetja e një mënyre për të arritur një lodër të caktuar), vëzhgoni nëse ata përdorin mendimin kritik për të gjetur zgjidhje. Shikoni se si fëmijët planifikojnë dhe ekzekutojnë hapat për të arritur një rezultat të caktuar. Përfshirja e tyre në lojëra që kërkojnë zgjidhje problemesh apo eksperimentim të thjeshtë ndihmon në vëzhgimin e aftësive të tyre hulumtuese.

### d) Bashkëpunimi dhe diskutimet me të tjerët

Fëmijët parashkollorë shpesh zhvillojnë aftësi kërkimore përmes bashkëveprimit me shokët e tyre. Vëzhgoni se si ata ndajnë idetë dhe pyetjet me të tjerët dhe nëse punojnë së bashku për të eksploruar një temë të caktuar. Ndonjëherë fëmijët mësojnë përmes imitimit ose duke pyetur të tjerët, dhe kjo mund të jetë një pjesë e rëndësishme e aftësive të tyre hulumtuese.

## B. Treguesi i cilësisë: Analiza dhe interpretimi i të dhënave duke përdorur teknika të përshtatshme

Vëzhgimi dhe vlerësimi i aftësive të analizës dhe interpretimit të të dhënave, fakteve dhe ngjarjeve tek fëmijët parashkollorë kërkon një qasje të ndjeshme që merr parasysh zhvillimin e tyre kognitiv. Në këtë fazë, këto aftësi janë në nivel fillestar dhe zakonisht shfaqen përmes mënyrës se si fëmijët përpunojnë informacionin, bëjnë lidhje logjike dhe shprehin mendime mbi ato që shohin dhe përjetojnë gjatë aktiviteteve mësimore.

### a) Aftësia e fëmijëve për të bërë krahasime

Fëmijët shpesh fillojnë të analizojnë të dhëna dhe fakte duke krahasuar objekte, ngjarje ose fenomene të thjeshta. Vëzhgoni nëse ata krahasojnë elementë gjatë lojës, si: "Ky top është më i madh se tjetri" ose "Lulet kanë ngjyra të ndryshme". Një aktivitet i thjeshtë që mund të përdorni është të paraqisni dy ose më shumë objekte dhe t'u kërkoni fëmijëve t'i krahasojnë ato në bazë të ngjyrës, madhësisë, formës apo funksionit.

### b) Aftësia e fëmijëve për të kategorizuar informacionin e dhënë

Aftësia për të kategorizuar dhe klasifikuar informacione apo objekte është një shenjë e analizës së të dhënave. Vëzhgoni nëse fëmijët janë në gjendje të ndajnë objekte në kategori, si për shembull ndarjen e lodrave sipas llojit (kafshë, mjete transporti) ose ushqimeve sipas grupit (fruta, perime). Kjo aftësi mund të stimulohet gjatë aktiviteteve ku fëmijët janë të përfshirë në lojëra klasifikimi, si p.sh. ndarja e kartave me figura të ndryshme në grupe.

#### c) Aftësia e fëmijëve për të njohur lidhjet shkak-pasojë

Shkaku dhe pasoja janë elemente kyçe të interpretimit të ngjarjeve dhe analizës së tyre. Vëzhgoni nëse fëmijët janë në gjendje të kuptojnë lidhje të thjeshta shkak-pasojë, si: “Nëse e hedh këtë gur, do të bjerë poshtë” ose “Kur bie shi, ne përdorim çadër”. Këto lidhje mund të vëzhgohen gjatë eksperimenteve të thjeshta në klasë, si p.sh. eksperimentet me ujë ose me bimë që tregojnë rezultate të dukshme dhe të menjëhershme.

#### d) Mënyra se si fëmijët ndërtojnë arsyetime logjike

Fëmijët parashkollorë fillojnë të përdorin arsyetimin logjik kur përballen me probleme që kërkojnë zgjidhje. Shikoni nëse ata janë në gjendje të gjejnë zgjidhje logjike për situata të caktuara, si për shembull ndërtimi i një strukture me blloqe ose vendosja e rrobave në bazë të stinës. Vëzhgoni nëse ata mund të shpjegojnë me fjalët e tyre se përse e kanë bërë një veprim të caktuar dhe çfarë kanë vërejtur si rezultat.

#### e) Aftësia e fëmijëve për të interpretuar ngjarje

Fëmijët shpesh interpretojnë ngjarjet që ndodhin rreth tyre duke i lidhur me përvojat e tyre personale. Vëzhgoni se si fëmijët reagojnë ndaj një ngjarjeje të re dhe përpiquni të kuptoni se si ata e përpunojnë informacionin. Për shembull, pas një ekskursioni në park ose kopsht zoologjik, mund t’i pyesni fëmijët çfarë kujtojnë dhe çfarë përfundimesh nxjerrin nga ajo që kanë parë.

#### f) Gjuha e përdorur për të bërë analiza të thjeshta

Përdorimi i gjuhës për të shpjeguar mendimet e tyre është një pjesë e rëndësishme e aftësisë së interpretimit. Shikoni nëse fëmijët përdorin fjalë dhe fjali për të shpjeguar idetë e tyre dhe për të analizuar ngjarje, objekte apo veprime. Për shembull, mund të vëzhgoni nëse ata shprehin mendime të tilla si: "Unë mendoj se...", "…, sepse...".

### C. Treguesi i cilësisë: Aftësitë e prezantimit të rezultateve të projektit

Vëzhgimi dhe vlerësimi i aftësive të prezantimit të rezultateve dhe produktit nga ana e fëmijëve parashkollorë është një proces që ndihmon në zhvillimin e aftësive të komunikimit, vetëbesimit dhe të shprehjes së ideve në mënyrë të qartë dhe të strukturuar. Në këtë moshë, fëmijët fillojnë

të mësojnë si të ndajnë përfundimet dhe përvojat e tyre me të tjerët përmes fjalës, vizatimeve, lojërave apo tregimeve.

**a) Aftësitë e fëmijëve për të shpjeguar projektin e tyre**

Vëzhgoni nëse fëmijët janë në gjendje të tregojnë për punën që kanë bërë dhe rezultatet që kanë arritur. Fëmijët duhet të jenë në gjendje të përshkruajnë procesin që kanë ndjekur, materialet që kanë përdorur, dhe pse kanë bërë zgjedhje të caktuara. Për shembull, gjatë një prezantimi për një projekt mbi natyrën, ata mund të tregojnë se si kanë mbjellë një farë dhe çfarë kanë vëzhguar gjatë rritjes së saj.

**b) Aftësitë e fëmijëve për të përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm**

Shikoni nëse fëmijët përdorin fjalë të përshtatshme për të përshkruar veprimet e tyre dhe produktin final. Në këtë fazë, fëmijët nuk kanë fjalor të avancuar, por është e rëndësishme që të përdorin terma të thjeshtë dhe të kuptueshëm për të shpjeguar atë që kanë mësuar. Për shembull, në një projekt për kafshët, ata mund të përdorin fjalë si "jetojnë", "hanë", "ngjyra", "këmbët" për të shpjeguar përshkrimin e kafshës së tyre.

**c) Aftësitë e fëmijëve për të përdorur ndihma vizuale (vizatime, modele, lojëra)**

Fëmijët parashkollorë shpesh ndihmohen nga ndihmat vizuale për të prezantuar rezultatet e tyre. Vëzhgoni nëse fëmijët përdorin vizatime, modele ose lojëra për të ndihmuar në shpjegimin e asaj që kanë bërë. Për shembull, një fëmijë mund të përdorë një vizatim të një peme për të treguar se si ajo rritet, ose mund të ndërtojë një model të thjeshtë me materiale të ndryshme për të demonstruar përfundimet e projektit.

**d) Aftësitë e fëmijëve për të "komunikuar" me audiencën (mësues, prindër, fëmijë të tjerë)**

Prezantimi përfshin gjithashtu aftësinë për të komunikuar me të tjerët dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve. Vëzhgoni nëse fëmijët janë të gatshëm të ndajnë rezultatet e tyre me audiencën dhe nëse janë në gjendje të përgjigjen në pyetje të thjeshta që mund të lindin nga të tjerët. Fëmijët që janë në gjendje të shpjegojnë idetë e tyre dhe t'i komunikojnë ato me audiencën tregojnë se kanë zhvilluar aftësi të mira prezantimi.

### e) Vetëbesimi dhe qartësia e fëmijëve në komunikim

Shikoni nëse fëmijët ndihen të sigurt gjatë prezantimit të projektit të tyre. Vëzhgoni gjuhën e trupit, zërin dhe mënyrën se si ata paraqesin idetë e tyre. Vetëbesimi i fëmijëve në prezantimin e rezultateve është një tregues i rëndësishëm i zhvillimit të aftësive komunikative. Nëse ata shfaqin vetëbesim gjatë komunikimit, kjo tregon që ata ndihen të sigurt në atë që kanë bërë dhe janë të gatshëm të ndajnë përvojën e tyre me të tjerët.

| **Kriteret për vlerësimin e projektit kurrikular për kategorinë "Mësues specialist"**<br>**Gjithsej 40 pikë** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Përshkruesi** | **Niveli 1**<br>**(Dobët)** | **Niveli 2**<br>**(Mjaftueshëm)** | **Niveli 3**<br>**(Mirë)** | **Niveli 4**<br>**(Shumë mirë)** |
| **Demonstrimi nga fëmijët i aftësive hulumtuese, kërkimore, krijuese (12 pikë)** | | | | |
| **Demonstrim nga fëmijët i aftësive hulumtuese, kërkimore dhe krijuese (3 pikë)** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | • Fëmijët nuk shfaqin kureshtje për të eksploruar mjedisin që i rrethon;<br>• Fëmijët nuk përpiqen për të zgjidhur probleme të thjeshta;<br>• Mjedisi i klasës është i varfër me materiale dhe mjete që nxisin fëmijët të | • Fëmijët shfaqin kuriozitet dhe përpiqen të bëjnë pyetje, të eksplorojnë, por mjedisi nuk i stimulon me lodra, objekte nga natyra, etj.;<br>• fëmijët tërhiqen para sfidave dhe nuk u japin dot zgjidhje situatave në të cilat ndodhen; | Fëmijët:<br>• shfaqin kuriozitet dhe bëjnë pyetje të rëndësishme gjatë eksplorimit të mjedisit;<br>• kanë mbledhur prova gjatë eksplorimeve të ndryshme;<br>• përpiqen për të zgjidhur probleme të | Fëmijët:<br>• marrin pjesë në aktivitete hulumtuese;<br>• shfaqin kuriozitet dhe bëjnë pyetje të rëndësishme;<br>• përdorin mënyra të ndryshme të përdorimit të materialeve;<br>• përdorin 'gjuhë' të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | eksplorojnë apo të bëjnë pyetje për të shuar kureshtjen e tyre. | • fëmijët përpiqen, por paraqesin vështirësi për të arritur rezultate.<br>• Mësuesi i ndihmon fëmijët të zhvillojnë disa aftësi kërkimore përmes bashkëveprimit të fëmijëve me njëri-tjetrin. | thjeshta<br>• kërkojnë ndihmën e mësuesit për të shprehur idetë e tyre;<br>• në pjesën më të madhe të veprimtarive kanë punuar së bashku dhe kanë ndarë idetë dhe mendimet me njëri-tjetrin.<br><br>Mësuesi<br><br>• nxit fëmijët të mendojnë në mënyrë kritike dhe duke i inkurajuar të eksplorojnë mundësi të ndryshme;<br>• nxit kuriozitetin dhe dëshirën e fëmijëve për të mësuar;<br>• nxit fëmijët të | ndryshme për të shprehur idetë e tyre;<br>• punojnë së bashku për të hulumtuar rreth një teme, duke ndihmuar dhe ndarë idetë dhe mendimet me njëri-tjetrin.<br><br>Mësuesi<br><br>• nxit fëmijët të mendojnë në mënyrë kritike, duke i pyetur për arsyetimet pas vendimeve të tyre dhe duke i inkurajuar të eksplorojnë mundësi të ndryshme;<br>• nxit kuriozitetin dhe dëshirën e fëmijëve për të mësuar;<br>• nxit fëmijët të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | përdorin imagjinatën e tyre dhe të jenë krijues në zgjidhjen e problemeve dhe realizimin e projektit. | përdorin imagjinatën e tyre dhe të jenë krijues në zgjidhjen e problemeve dhe realizimin e projektit. |
| **Bashkëpunimi në grup (3 pikë)** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | Fëmijët:<br>• nuk aktivizohen në diskutime dhe aktivitete grupi;<br>• paraqesin vështirësi në bashkëpunim me njëri-tjetrin.<br><br>Mësuesi:<br>• nuk organizon veprimtari që fëmijët të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. | Fëmijët:<br>• aktivizohen në diskutime dhe në aktivitete grupi kur ua kërkon mësuesi;<br>• marrin pjesë më shumë në veprimtari individuale;<br>• nuk marrin iniciativë për punë të përbashkëta.<br><br>Mësuesi:<br>• inkurajon fëmijët të | Fëmijët:<br>• përfshihen në diskutime dhe aktivitete grupi;<br>• krijojnë produkte të përbashkëta;<br>• përpiqen së bashku për t'i dhënë zgjidhje 'problemeve' që u dalin;<br>• u përgjigjen pyetjeve që u bëhen për produktet e përbashkëta;<br>• ndihmoj në njëri-tjetrin | Fëmijët:<br>• marrin pjesë aktive në diskutime dhe aktivitete grupi;<br>• krijojnë produkte të përbashkëta;<br>• japin kontribute në diskutime;<br>• punojnë së bashku, ndajnë mendime dhe koordinojnë aktivitetet e tyre;<br>• mësojnë të punojnë së bashku dhe të respektojnë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | punojnë së bashku, por nuk arrin rezultate konkrete;<br>• fëmijët ndajnë idetë me njëri-tjetrin në mënyrë sporadike. | në përfundimin e aktiviteteve.<br><br>Mësuesi:<br><br>• inkurajon fëmijët të punojnë së bashku;<br>• ndihmon fëmijët të punojnë në grup;<br>• inkurajon fëmijët të shprehin mendimet e tyre, të dëgjojnë të tjerët dhe të komunikojnë në mënyrë efektiv. | mendimet e njëri-tjetrit;<br>• tregojnë empati për ndjenjat dhe idetë e bashkëmoshatarëve;<br>• menaxhojnë situata tensioni ose konflikti;<br>• arrijnë rezultate në punën që kryejnë.<br><br>Mësuesi:<br><br>• nxit fëmijët për të marrë iniciativa për të udhëhequr grupin;<br>• Inkurajon fëmijët të punojnë së bashku për të zhvilluar aftësitë e komunikimit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | dhe bashkëpunimit;<br>• luan rolin e ndërmjetësit për të ndihmuar fëmijët të punojnë në grup, duke i mësuar ata të ndajnë detyrat dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin;<br>• ndihmon në ndërtimin e aftësive për bashkëpunim dhe ndarje të ideve, duke nxitur ndërveprimin social;<br>• inkurajon fëmijët të shprehin mendimet e tyre, të dëgjojnë të tjerët dhe të komunikojnë në mënyrë efektive përmes bisedave |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | të strukturuara dhe të hapura. |
| **Përqendrimi i fëmijëve te aktivitetet (3 pikë)** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | Fëmijët:<br><br>• janë të shpërqendruar;<br>• nuk e ruajnë fokusin te detyra që po punojnë;<br>• Mësuesi nuk i ka nën kontroll veprimet e fëmijëve. | Fëmijët:<br><br>• ruajnë fokusin te detyra që po punojnë dhe ndajnë idetë me njëri-tjetrin;<br>• ndjekin radhën e veprimeve.<br><br>Mësuesi:<br><br>• ndihmon fëmijët duke treguar se si t'i përdorin materialet në mënyrë të sigurt dhe të saktë;<br>• lavdëron fëmijët që përfundojnë detyrat në kohë dhe me cilësi;<br>• përpiqet të krijojë një mjedis të qetë | Fëmijët:<br><br>• janë të fokusuar në detyrat e përbashkëta;<br>• bisedojnë dhe ndajnë idetë me njëri-tjetrin;<br>• përdorin mënyra të ndryshme në përdorimin e materialeve.<br><br>Mësuesi:<br><br>• krijon një atmosferë ku fëmijët kanë mundësi të eksplorojnë;<br>• ndihmon fëmijët duke treguar se si t'i përdorin materialet në | Fëmijët:<br><br>• ndihen më të angazhuar dhe të përgjegjshëm për procesin e të mësuarit;<br>• janë të fokusuar në detyrat e përbashkëta;<br>• provojnë gjëra të reja, por të lidhur me detyrën që po kryejnë;<br>• ruajnë fokusin te detyra kur diskutojnë dhe ndajnë idetë me njëri-tjetrin.<br><br>Mësuesi:<br><br>• krijon një atmosferë ku fëmijët ndihen |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | që ndikon në përqendrimin e fëmijëve. | mënyrë të sigurt dhe të saktë;<br>• lavdëron fëmijët që përfundojnë detyrat në kohë dhe me cilësi;<br>• krijon një mjedis që ndikon pozitivisht në përqendrimin e fëmijëve. | të lirë të eksplorojnë, të bëjnë gabime dhe të mësojnë prej tyre;<br>• ndihmon fëmijët duke treguar se si t'i përdorin materialet në mënyrë të sigurt dhe të saktë;<br>• lavdëron fëmijët që përfundojnë detyrat në kohë dhe me cilësi;<br>• krijon një mjedis që ndikon pozitivisht në përqendrimin e fëmijëve. |
| **Përshtatshmëria e informacioneve me detyrat (3 pikë)** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | • Informacionet e mbledhura nga fëmijët dhe mësuesi janë të pakta;<br>• fëmijët bëjnë përpjekje për t'i lidhur | Fëmijët:<br>• përdorin pak burime për të marrë informacion; | Fëmijët:<br>• përdorin burime të ndryshme për të mbledhur informacionin që u duhet për | Fëmijët:<br>• përdorin burime të ndryshme si libra, fotografi ose burime digjitale; |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | informacionet dhe për të nxjerrë një përfundim;<br>• mësuesi nuk i ndihmon fëmijët të tregojnë çfarë kanë mësuar prej informacioneve të mbledhura. | • interpretojnë informacione;<br>• paraqesin vështirësi në lidhjen ndërmjet fakteve;<br>• interpretojnë informacionin e mbledhur, por hasin vështirësi për të nxjerrë përfundime të vlefshme;<br>• mësuesi ndalet pak në interpretimin e informacionit dhe përshtatjen e tij me detyrën. | detyrën që po kryejnë;<br>• analizojnë dhe interpretojnë informacionet e mbledhura;<br>• dallojnë se cili informacion është i vlefshëm për detyrën që po kryejnë;<br>• zhvillojnë mendime të reja gjatë përpunimit të informacionit;<br><br>Mësuesi:<br><br>• nxit fëmijët të analizojnë se si përshtatet informacioni me detyrën e dhënë. | • analizojnë dhe interpretojnë informacione;<br>• bëjnë lidhje midis fakteve dhe formulojnë mendime të reja;<br>• analizojnë dhe interpretojnë informacionin e mbledhur dhe nxjerrin përfundime të vlefshme;<br>• zhvillojnë aftësitë e tyre për të mbledhur, përpunuar dhe përdorur informacionin në mënyrë efektive;<br>•<br><br>Mësuesi:<br><br>• nxit fëmijët të diskutojnë për informacionin e |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | mbledhur dhe e analizojnë së bashku;<br>• ndihmon fëmijët të përzgjedhin informacionin për detyrën që u duhet;<br>• siguron materiale që nxisin kreativitetin e fëmijëve;<br>• koordinon aktivitete të ndryshme, për të cilat fëmijët përdorin burime efektive. |
| **Analiza dhe interpretimi i të dhënave duke përdorur teknika të përshtatshme (10 pikë)** | | | | |
| **Përdorimi i teknikave të përshtatshme, efektive, krijuese, origjinale (3 pikë)** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | • Gjatë realizimit të projektit, fëmijët nuk kanë përdorur teknika të përshtatshme për analizën dhe | Fëmijët:<br>• kanë përdorur të njëjtat teknika për të bërë interpretime të | Fëmijët:<br>• nëpërmjet shembujve konkretë analizojnë të dhënat; | Fëmijët:<br>• kanë përdorur teknika të ndryshme, si vëzhgime, vizatime, grupime, |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | interpretimin e të dhënave;<br>• fëmijët nuk kanë bërë krahasime, grupime, klasifikime duke përdorur ngjyra në përpunimin e të dhënave.<br>• mësuesi nuk zotëron njohuri për përdorimin e teknikave të përshtatshme për të organizuar dhe analizuar të dhënat;<br>• mësuesi nuk i nxit fëmijët të bëjnë interpretime të të dhënave, të rezultateve dhe të përfundimeve që kanë nxjerrë fëmijët gjatë projektit. | të dhënave gjatë gjithë projektit;<br>• paraqesin vështirësi në analizën dhe interpretimin e të dhënave.<br><br>Mësuesi:<br><br>• kërkon nga fëmijët të bëjnë analiza dhe të nxjerrin përfundime nga të dhënat e grumbulluara.<br>• nuk përfshin në interpretimin e të dhënave të gjithë fëmijët;<br>• përpiqet t'i nxisë fëmijët nëpërmjet pyetjeve të bëjnë analiza dhe interpretime. | • gjatë projektit kanë krijuar diagrame, tabela, që i ndihmojnë të bëjnë interpretime;<br>• me ndihmën e mësuesit, mbledhin, përpunojnë dhe analizojnë të dhënat;<br><br>Mësuesi:<br><br>• ndihmon fëmijët në analizën dhe interpretimin e të dhënave;<br>• i nxit fëmijët nëpërmjet pyetjeve dhe 'sfidave' për të bërë analiza e interpretime të reja.<br>• përpiqet që çdo fëmijë të bëjë analiza e | klasifikime për të bërë analizën dhe interpretimin e të dhënave;<br>• nëpërmjet shembujve të thjeshtë e konkretë fëmijët analizojnë të dhëna dhe krijojnë diagrame, tabela, vizatime dhe ilustrime;<br>• ndajnë përvojat dhe mendimet për rezultatet e arritura në grup;<br>• zhvillojnë aftësitë e tyre për të mbledhur, përpunuar dhe përdorur informacionin në mënyrë efektive;<br>• reflektojnë mbi procesin e kryer dhe diskutojnë për |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | interpretime të thjeshta;<br>• siguron mjete dhe materiale që fëmijët t'i mbledhin e t'i analizojnë të dhënat në mënyrë praktike. | teknikat e përdorura.<br><br>Mësuesi:<br><br>• zhvillon aftësitë e mendimit kritik dhe analitik të fëmijëve në analizën dhe interpretimin e të dhënave;<br>• vlerëson punën dhe përpjekjet e fëmijëve duke rritur interesin e tyre për analiza dhe interpretime të dhënash;<br>• i nxit fëmijët nëpërmjet pyetjeve dhe 'sfidave' për të bërë analiza e interpretime të reja;<br>• mbështet fëmijët që paraqesin vështirësi në analizën dhe |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | interpretimin e të dhënave, duke ofruar udhëzime të personalizuara;<br>• siguron mjete dhe materiale që fëmijët, t'i mbledhin dhe t'i analizojnë të dhënat në mënyrë praktike. |
| **Analiza, interpretimi dhe zgjidhja e problemeve (3 pikë)** | **0 pikë** | **1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** |
| | • Fëmijët nuk demonstrojnë aftësi të analizës dhe interpretimit të të dhënave, fakteve dhe ngjarjeve;<br>• Fëmijët nuk bëjnë lidhje logjike të të dhënave;<br>• mësuesi nuk kërkon nga fëmijët të interpretojnë, të sjellin përvoja të | Fëmijët:<br>• shfaq aftësi të analizës së të dhënave, por nuk bëjnë interpretime të tyre;<br>• paraqesin vështirësi në krijimin e lidhjeve logjike mes ngjarjeve;<br>• shfaqin mendime për ngjarjet që | Fëmijët:<br>• shfaqin aftësi të analizës dhe interpretimit të të dhënave, fakteve dhe ngjarjeve;<br>• bëjnë lidhje logjike dhe shprehin mendimet e tyre mbi ato që shohin dhe përjetojnë; | Fëmijët:<br>• identifikojnë dhe analizojnë elementët kyç të informacionit të mbledhur për projektin;<br>• formulojnë hipoteza të arsyeshme mbi informacionin që analizojnë;<br>• diskutojnë dhe ndajnë ide |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | ngjashme, të kuptojnë lidhjet shkak-pasojë të ngjarjeve, të bëjnë krahasime dhe klasifikime të thjeshta. | përjetojnë vetëm nëse pyeten;<br>• bëjnë krahasime mes 2 objekteve konkretë;<br>• paraqesin vështirësi në analizat shkak-pasojë;<br>• hasin vështirësi për të gjetur zgjidhje në problemet që hasin.<br><br>Mësuesi:<br>• nuk i motivon fëmijët të bëjnë krahasime, analiza shkak-pasojë, arsyetime logjike rreth informacioneve, objekteve, ngjarjeve të thjeshta;<br>• kërkon nga fëmijët të bëjnë | • bëjnë krahasime mes objekteve, ngjarjeve dhe dukurive të thjeshta;<br>• bëjnë lidhje të thjeshta shkak-pasojë;<br>• përpiqen të gjejnë zgjidhje në problemet që hasin.<br><br>Mësuesi:<br>• i nxit fëmijët të bëjnë lidhje të ngjarjeve me përvoja personale;<br>• kërkon nga fëmijët të bëjnë analiza dhe interpretime bazuar në mendimet e tyre. | për të gjetur zgjidhje;<br>• komunikojnë idetë dhe informacionet në një mënyrë të kuptueshme;<br>• ofrojnë zgjidhje për problemet e hasura gjatë zhvillimit të projektit;<br>• ndihmoj në njëri-tjetrin në interpretimin e të dhënave.<br><br>Mësuesi:<br><br>• luan rolin e lehtësuesit duke u ofruar fëmijëve ndihmë të kujdesshme për të zgjidhur problemet dhe mundësi të mendojnë për zgjidhje në mënyrë të pavarur; |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | interpretime, por nuk bën përmbledhjen dhe vijimin e shfaqjes së mendimeve të reja të fëmijëve. | | • ndihmon fëmijët të zhvillojnë aftësitë e tyre analitike dhe interpretuese; • justifikon zgjidhjet e fëmijëve dhe jep arsye për vlefshmërinë e tyre; • analizon se si grupi i fëmijëve e përballon zgjidhjen e problemeve. |
| **Përdorimi i skemave dhe diagrameve të ndryshme (4 pikë)** | **0-1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** | **4 pikë** |
| | • Fëmijët nuk kanë përdorur skema dhe diagrame të thjeshta gjatë zhvillimit dhe prezantimit të projektit ; • Fëmijët nuk e kanë të organizuar paraqitjen | Fëmijët: • kanë përdorur vizatime për të ilustruar ide dhe koncepte, por paraqesin vështirësi të tregojnë pse i kanë zgjedhur; • punimet janë të varfra | Fëmijët: • kanë përdorur simbole të thjeshta për të shfaqur ide; • kanë paraqitur ide në mënyra krijuese; • kanë punuar së | Fëmijët: • kanë përdorur simbole dhe forma për të ilustruar ide dhe koncepte dhe tregojnë edhe pse i kanë zgjedhur; • përdorin kanë përdorur |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | vizuale të projektit;<br>• nuk kanë krijimtari dhe origjinalitet në punimet e krijuara;<br>• Mësuesi nuk është kujdesur për t'i ndihmuar fëmijët t'i organizojnë materialet në skema e diagrame, për të qenë më i kuptueshëm informacioni i paraqitur. | me mënyra krijuese dhe origjinale;<br>• paraqesin vështirësi në krijimin e skemave dhe të diagrameve.<br><br>Mësuesi:<br><br>• nuk i nxit fëmijët të përdorin materiale të larmishme vizuale;<br>• nuk i ndihmon fëmijët të krijojnë skema të thjeshta në organizimin e figurave dhe të vizatimeve. | bashku për të krijuar skema dhe diagrame të thjeshta.<br>• në produktin final kanë përfshirë skema dhe diagrame të thjeshta.<br><br>Mësuesi:<br><br>• i ka nxitur fëmijët të përdorin materiale vizuale si figura, piktura ose grafikë të thjeshtë;<br>• ka ndihmuar fëmijët të organizojnë informacionin në diagrame dhe skema të thjeshta. | ngjyrat dhe format për të theksuar elementë të rëndësishëm;<br>• kanë paraqitur idetë dhe rezultatet e tyre në një mënyrë krijuese;<br>• kanë punuar së bashku për të krijuar skema dhe diagrame.<br>• kanë krijuar një produkt final që përfshin skema dhe diagrame.<br><br>Mësuesi:<br><br>• ka nxitur fëmijët të përdorin materiale vizuale si figura, piktura ose grafikë për të mbështetur |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | informacionin që paraqesin;<br>• ka ndihmuar fëmijët të organizojnë informacionin në mënyrë logjike përmes diagrameve<br>• është kujdesur që idetë e të gjithë fëmijëve të jenë prezantuar nëpër skema e diagrame. |
| **Aftësitë e prezantimit të projektit (18 pikë)** | | | | |
| **Organizimi i materialeve dhe qartësia në të kuptuarit e tij (6 pikë)** | **0-1 pikë** | **2-3 pikë** | **4-5 pikë** | **6 pikë** |
| | • Materiale t e fëmijëve nuk janë organizuar në mënyrë të qartë, logjike dhe të kuptueshme;<br>• materialet janë të shpërndara në disa produkte pa krijuar lidhje | Fëmijët:<br>• janë përpjekur që materialet të jenë të organizuara qartë dhe në mënyrë të dukshme;<br>• punimet dhe materialet | Fëmijët:<br>• i kanë vendosur materialet sipas rrjedhës logjike të zhvillimit të projektit;<br>• material et janë organizuar në mënyrë të qartë, | Fëmijët:<br>• janë kujdesur për organizimin e materialeve sipas hapave të projektit;<br>• materiale t janë të thjeshta dhe në përshtatje me |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | kuptimplota midis tyre;<br>• mënyra e organizimit të materialeve nuk e tregon lidhjen midis aktiviteteve të realizuara në faza të ndryshme të projektit.<br>• mënyra e organizimit të materialeve u krijon fëmijëve vështirësi për të treguar punën që kanë kryer. | janë të grupuara sipas llojit të tyre (vizatime, punime artizanale, modelime etj.)<br>• përpiqen të përshkruajnë hapat e projektit nisur nga radha e vendosjes së materialeve;<br>• Mësuesi i ndihmon fëmijët për t'i organizuar materialet në mënyrë të strukturuar dhe të qartë.<br>• organizimi i materialeve dhe paraqitja e tyre i ndihmon fëmijët të përshkruajnë projektin hap pas hapi.<br>• materialet në përgjithësi i përmbahen | të thjeshtë dhe të kuptueshme;<br>• materialet tregojnë punën e secilit prej tyre;<br>• ndihen të sigurt dhe besojnë në aftësitë e tyre të organizimit të materialit;<br>• materialet janë organizuar në mënyrë tërheqëse dhe të përshtatshme për fëmijët;<br>• punimet e përgatitura kanë lidhje me qëllimet e projektit dhe pasqyrojnë ecurinë e tij hap pas hapi.<br><br>Mësuesi:<br><br>• i ndihmon fëmijët të | zhvillimin e tyre moshor;<br>• materialet u përkasin të gjitha fushave kurrikulare;<br>• materialet kanë nxitur pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin midis njëri-tjetrit;<br>• zhvillojnë aftësitë e dëgjimit për të kuptuar më mirë pyetjet dhe reagimet e të tjerëve;<br>• përshkruajnë procesin që kanë ndjekur në realizimin e projektit hap pas hapi.<br><br>Mësuesi:<br><br>• ka dokumentuar të gjitha punimet që dëshmojnë si |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | temës së projektit. | organizojnë punimet dhe materialet e tyre në mënyrë logjike, duke filluar nga një hyrje, përshkrimi i detajeve dhe përfundimi;<br>• ka ndjekur progresin e secilit fëmijë, duke vëzhguar se si ata punojnë dhe ndër veprojnë me materialet dhe me njëri-tjetrin.<br>• ka ruajtur në formë digjitale të gjitha materialet e përzgjedhura nga fëmijët dhe punimet e kryera në kuadër të projektit. | nisi dhe u zhvillua projekti.<br>• ka mbajtur shënime të mendimeve dhe thënieve të fëmijëve gjatë projektit;<br>• materiale t e krijuara nga fëmijët janë të larmishme, si punime artistike, vizatime, shkrime, punë artizanale etj.<br>• i ndihmon fëmijët të organizojnë idetë e tyre në mënyrë logjike, duke filluar nga një hyrje, përshkrimi i detajeve dhe përfundimi;<br>• u siguron fëmijëve çfarë u nevojitet për të realizuar |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | aktivitetet e planifikuara;<br>• ndjek progresin e secilit fëmijë, duke vëzhguar se si ata punojnë dhe ndër veprojnë me materialet dhe me njëri-tjetrin.<br>• ka ruajtur në formë digjitale të gjitha materialet e përzgjedhura nga fëmijët dhe punimet e kryera në kuadër të projektit. |
| **Origjinaliteti i rezultateve të projektit dhe prezantimi i tyre (6 pikë)** | **0-1 pikë** | **2-3 pikë** | **4-5 pikë** | **6 pikë** |
| | • Projekti nuk i ka përmbushur të gjitha rezultatet e tij;<br>• në realizimin e projektit mbizotëron | Fëmijët:<br>• janë përfshirë në realizimin e projektit;<br>• përshkruajnë me ndihmën e të rriturit çfarë | Fëmijët:<br>• ndihen mirë dhe pjesë të projektit.<br>• tregojnë për kontributin që kanë dhënë në projekt | Fëmijët:<br>• ndihen të sigurt gjatë prezantimit të projektit;<br>• kanë përgatitur në mënyrë të qartë dhe të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | kontributi i disa fëmijëve; • fëmijët paraqesin vështirësi në prezantimin e projektit; • në realizimin e punimeve të projektit nuk del i qartë bashkëpunimi ndërmjet fëmijëve; • mësuesi nuk ka dokumentuar momente të ndërveprimit të fëmijëve me njëri-tjetrin dhe realizimin e punimeve të përbashkëta; • punimet dhe krijimet e fëmijëve nuk kanë larmi dhe nuk dëshmojnë aftësi krijuese dhe origjinale. | kanë mësuar gjatë projektit; • shfaqin dëshirë për të prezantuar punimin e tyre; • u përgjigjen pyetjeve që u bëhen • në përgjithësi, punimet janë krijuese; • punimet paraqesin rezultate të nxëni; • kanë emocione dhe nuk përshkruajnë deri në fund; • paraqesin vështirësi në menaxhimin e emocioneve; • humbasin përqendrimin gjatë prezantimit të shokëve. | • përshkruajnë me fjalë të thjeshta momente gjatë realizimit të projektit; • i shprehin rezultatet e tyre me gjuhën e tyre. • rezultatet e punës janë të dukshme; • shfaqin krenari, gëzim dhe besim te puna e kryer. Mësuesi: • u jep mundësi fëmijëve të prezantojnë çfarë kanë arritur, duke i inkurajuar të flasin për atë që kanë bërë dhe si e kanë realizuar; | kuptueshëm prezantimin; • kanë përdorur materiale vizuale (si skema, diagrame, ose figura) për të mbështetur prezantimin; • tregojnë interes dhe pasion gjatë prezantimit; • produkti përfundimtar është kontribut i të gjithë fëmijëve; Mësuesi: • u jep mundësi fëmijëve të prezantojnë rezultatet e projektit të tyre përpara një audience, duke i inkurajuar të flasin për atë që |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | • vlerëson punën e çdo fëmije;<br>• ka të dokumentuar arritjet e fëmijëve;<br>• aktivitetet që kanë kryer fëmijët janë në interesin dhe sipas mundësive të tyre;<br>• pyet fëmijët për rezultatet që kanë arritur. | kanë bërë dhe si e kanë realizuar;<br>• organizon p.sh.: një ekspozitë ku fëmijët shfaqin punën e tyre përpara prindërve dhe komunitetit;<br>• ndihmon fëmijët të organizojnë idetë e tyre në mënyrë logjike;<br>• thekson rëndësinë e përpjekjeve që kanë bërë fëmijët, duke u fokusuar në procesin e të mësuarit përveç rezultateve;<br>• vlerëson çfarë kanë mësuar fëmijët dhe si i kanë arritur rezultatet;<br>• diskuton me fëmijët për atë që u ka |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | pëlqyer dhe çfarë kanë mësuar nga projekti. |
| **Ndikimi pozitiv i vlerësimit në progresin e fëmijëve (6 pikë)** | **0-1 pikë** | **2-3 pikë** | **4-5 pikë** | **6 pikë** |
| | • Mësuesi përdor pak fjalë motivuese dhe mbështetëse për arritjet e fëmijëve;<br>• mësuesi përqendrohet në vlerësimin e arritjeve të fëmijëve, duke lënë mënjanë përpjekjet e tyre gjatë procesit.<br>• mësuesi ndalet më shumë në gjërat dhe aftësitë që duhet të përmirësojnë fëmijët në projektet e ardhshme;<br>• fëmijët nuk ndihen entuziastë për punën që kanë bërë; | • Mësuesi vlerëson në mënyrë të përmbledhur përfshirjen dhe angazhimin e fëmijëve në projekt;<br>• vlerëson aftësitë konjitive dhe sociale të fëmijëve;<br>• vlerëson përpjekjet e fëmijëve për të realizuar projektin;<br>• nuk vlerëson në mënyrë të veçantë përpjekjet e çdo fëmije;<br>• nuk vlerëson kreativitetin | Mësuesi:<br>• vlerëson përfshirjen e fëmijëve gjatë zhvillimit të veprimtarive të projektit;<br>• vlerëson fëmijët për zgjidhjen e problemeve të ndryshme;<br>• vlerëson fëmijët për bashkëpunimin me njëri-tjetrin;<br>• vlerëson fëmijët për kreativitetin, imagjinatën dhe origjinalitetin e punimeve;<br>• vlerëson progresin e fëmijëve gjatë | Mësuesi:<br>• vlerëson përfshirjen dhe motivimin e fëmijëve gjatë zhvillimit të veprimtarive të projektit;<br>• vlerëson fëmijët për interesin e tyre për të mësuar gjatë zhvillimit të aktiviteteve të projektit;<br>• vlerëson procesin më shumë sesa arritjet akademike të fëmijëve;<br>• vlerëson fëmijët për zgjidhjen kapërcimin e sidave dhe |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | • fëmijët nuk janë të vlerësuar | dhe origjinalitetin e punës së çdo fëmije<br>• nuk vlerëson bashkëpunimin e fëmijëve me njëri-tjetrin;<br>• nuk lidh synimet dhe qëllimet e projektit me rezultatet e arritura nga fëmijët;<br>• fëmijët ndihen mirë dhe të vlerësuar nga mësuesi;<br>• emocionet e fëmijëve ndikojnë në mos përfundimin e prezantimit të kontributeve që kanë dhënë gjatë projektit;<br>• fëmijët herë-herë nuk janë në koherencë të | gjithë zhvillimit të projektit;<br><br>Fëmijët:<br><br>• shfaqin vetëbesim për punën dhe përpjekjet që kanë bërë gjatë gjithë projektit, kur pyeten;<br>• përpiqen të vetë vlerësojnë performancën dhe reflektojnë mbi atë çfarë kanë mësuar;<br>• vlerësojnë bashkëpunimin dhe ndihmën që i kanë dhënë njëri-tjetrit. | zgjidhjen e problemeve që u kanë dalë përpara;<br>• vlerëson fëmijët për bashkëpunimin me njëri-tjetrin;<br>• vlerëson fëmijët për kreativitetin, imagjinatën dhe origjinalitetin e punimeve;<br>• jep komente pozitive dhe specifike për arritjet e fëmijëve;<br>• ofron mbështetje emocionale për fëmijët;<br>• vlerëson progresin e fëmijëve gjatë gjithë zhvillimit të projektit;<br>• analizon produktin përfundimtar të projekteve dhe |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | prezantimit të projektit | | mënyrën se si fëmijët e paraqesin atë.<br><br>Fëmijët:<br>• ndihen të suksesshëm dhe shfaqin vetëbesim për punën dhe përpjekjet që kanë bërë gjatë gjithë projektit;<br>• shprehin ndjenjat dhe emocionet e tyre përmes krijimit, diskutimeve dhe ndërveprimeve me të tjerët;<br>• vetë vlerësojnë performancën dhe reflektojnë mbi atë çfarë kanë mësuar;<br>• vlerësojn ë bashkëpunimin dhe ndihmën që |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | i kanë dhënë njëri-tjetrit. |

| **Kriteret për vlerësimin e projektit kurrikular për kategorinë "Mësues mjeshtër"<br>Gjithsej 70 pikë** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Përshkruesi** | **Niveli 1<br>(Dobët)** | **Niveli 2<br>(Mjaftueshëm)** | **Niveli 3<br>(Mirë)** | **Niveli 4<br>(Shumë mirë)** |
| **Demonstrimi nga fëmijët i aftësive hulumtuese, kërkimore, krijuese (20 pikë)** | | | | |
| **Demonstrim nga fëmijët i aftësive hulumtuese, kërkimore dhe krijuese (4 pikë)** | **0-1 pikë** | **2 pikë** | **3 pikë** | **4 pikë** |
